



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional në:

“Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm”

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Ermelinda Kordha

2. Prof. Asoc. Shpresim Domi

Qershor 2025

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Master Profesional

“Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Agrobiznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr.453, datë 14.08.2023
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.197, datë 16.07.2024
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik/dy simestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite
11	Forma e studimit:	
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhën Shqip dhe Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Me Universiteti Bujqësor - Plovdiv
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Menaxhim i Qendrueshem ne Agroturizem
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 i kornizës kombëtare
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023-2024 11 PAE 2024-2025 10 PAE 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2023-2024 4 studente 2024-2025 2 studente
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Masterit Profesional në Menaxhim I qëndrueshëm në Agroturizëm është një program i ofruar nga, Fakulteti i Bujqësisë, Departamenti i Agrobiznesit (DA), në Universitetin e Korçës "Fan S. Noli". Ky është një program në bashkëpunim me fakultetin e Ekonomisë në UNIKO si dhe me Fakultetin i ekonomisë në Universitetin e Plovdiv Bullgari (UBP). Ai është një program i ri i cili ka filluar në vitin 2022 dhe është ndërtuar si një program në dy fusha ndërdisiplinore të lidhura organikisht sic janë Bujqësia dhe Turizmi.

Hapja e programit të studimit u realizua me urdhër Nr. 453, Datë 14.08.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, mbi bazën e Vendimit Nr. 555, Datë 21.11.2022 të Senatit Akademik të UNIKO3 dhe Vendimit Nr. 571, Datë 25.11.2022 të Bordit të Administrimit. Kohëzgjatja e programit të studimit është një vit akademik (2 semestra), 60 kredite dhe ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze.

Programi MP MQA është një nga programet e masterit profesional në degën e bujqësisë dhe turizmit në hapësirën e institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri. Përgjithësisht universitetet të cilat janë të vendosura në zonat turistike të Shqipërisë kanë mbështetur ofrimin e programeve në degën e turizmit, ndër të cilat agroturizmi është një nënsektor i rëndësishëm, sidomos në mjediset dhe vendet ku zhvillimi bujqësor ka, për të mundësuar mbështetjen e tregut të punës në këtë sektor shumë të rëndësishëm dhe strategjik për Shqipërinë. Në këtë drejtim edhe Universiteti I Korçës në Fakultetin e Bujqësisë (FB) ka patur synim të paraqesë ofertën e tij, fillimisht me diplomën e nivelit të parë dhe më tej, duke u bazuar në kërkesën e studentëve për të mbështetur formimin e tyre edhe në ciklin e dytë të studimeve, ka bashkëpunuar për ofrimin e MP MQA. Sigurisht bazuar mbi kërkesat e studentëve, kjo është një iniciativë që plotëson ofertën me programe nga ana e FB, por ajo çfarë duhet të nxisë mënyrën se si kjo diplomë do të ofrohet në të ardhmen duhet të jetë kërkesa në tregun e punës, e cila gjithashtu nuk mungon.

Aktualisht programi i MP MQA përpiket të ndërtojë kompetenca bazë në aspektet e drejtimit të ndërmarrjeve në fushën e agroturizmit, duke u bazuar në dy grupe të kompetencave, ato në bujqësi dhe ato në turizëm, si në menaxhimin dhe marketingun, në destinacionet turistike, menaxhimin e burimeve natyrore, inovacionin në zhvillimin rural, zhvillimin e qëndrueshëm, etj. Në këtë aspekt, lëndët kanë profilin e bazave të menaxhimit dhe marketingut dhe një përshtatje me fushën e turizmit dhe atë të bujqësisë. Kjo strategji në ndërtimin e kurrikulës është ndërtuar në bashkëpunim me UPB, duke u bazuar gjerësisht në marrëveshjen e bashkëpunimit për hapjen e këtij programi si dhe në përvojën e UNIKO. Duke qenë një program i ri, ai i ka mundësitë të kontribuojë në mënyrë të qëndrueshme dhe të fortë në punësimin në rajon dhe më gjerë si dhe në përmirësimin e sektorit të agroturizmit. Për këtë program duhet të fokusohet edhe më tepër në prirjet e reja të industrisë agroturistike duke ofruar edhe më tepër formim në disa kompetenca specifike përveçse atyre të përgjithshme të lidhura me sektorin, të cilat programi i ofron aktualisht edhe për shkak të përvojës së gjatë në këto fusha të UNIKO.

Gjithashtu ndërtimi i kurrikulës është dhe rrjedhim i stafit akademik të programit, i cili ka në përbërje pedagogë që e kanë formimin parësor dhe kualifikimet e nevojshme si dhe një eksperiencë

të mirë në kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me institucione ndërkombëtare në projekte dhe mobilitete, në fushat përkatëse.

Në të ardhmen ky program masteri duhet të promovohet gjerësisht në hapësirën e programeve në fushën e bvuqjesisë dhe turizmit për tu diferencuar dhe për të ndërtuar një profil të qartë, që ta dallojë atë nga programet e tjera si dhe të tërheqë operatorët për të bashkëpunuar në identifikimin e burimeve njerëzore më të mira në fushën e turizmit, në menaxhimin e qëndrueshëm të ndërmarrjeve agroturistike.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Procesi i vlerësimit të jashtëm paraqitet si një proces që ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë dhe gjithë bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procedura përfshiu fillimisht kontaktin me ekspertët dhe grupin e Vlerësimit të Jashtëm GVJ, të cilët kanë qenë dhe më parë të angazhuar si ekspertë pranë ASCAL dhe njohin standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe me përdorimin e sistemit elektronik në pjesën e panelit të ekspertit. Vendosja e një komunikimi të mirë në grupin e punës midis ekspertëve dhe menaxherit teknik nga ASCAL është e rëndësishme për ecurinë e procesit. Pas njohjes dhe shfrytëzimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për diplomën përkatëse, u ndërtua një axhendë për vizitën në institucion, për të cilën u dakortësua midis grupit të punës. Hapi i radhës ishte realizimi i saj. Axhenda u zbatua me rigorozitet, duke ndikuar pozitivisht në mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të mëtejshme të cilat do të ndikonin në një vlerësim bazuar mbi informacion sa më të detajuar. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha dhe Prof. Asoc. Dr. Shpresim Domi. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj . Pas vizitës në terren u realizua raporti përfundimtar nga ekspertët e jashtëm dhe ky u dorëzua për rishikim nga ASCAL dhe për njohjen me të të GVB.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Misioni dhe vizioni i UNIKO për të nxitur dhe mbështetur formimin e specialistëve dhe shkencëtarëve të rinj, jepet përmes dokumentave themelore, si Statuti në nenin 2, 3 dhe 4, Plani Strategjik në 2022-2027 dhe rregulloren e UNIKO. Në to theksohet sidomos krijimi i një kulture akademike dhe baze njohurish dhe aftësish e cila synon përgatitjen e shëndoshë të studentëve për një mjedis konkurrues, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, bazuar sidomos në kapacitetet e zhvillimit local, rajonal dhe kombëtar. Gjithashtu, i jepet rëndësi ekselencës në mësimdhënie-nxënie, duke integruar njohuritë konceptuale dhe praktike ndërmjet disiplinave të ndryshme dhe botës akademike-biznesit. Përputhshmëria me interesat kombëtare paraqitet jo vetëm në dokumentacionin e Institucionit, por edhe në rregulloret e tjera të fakutetit dhe programit të studimit. Institucioni i Arsimit të Lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master Profesional” në përputhje me interesat kombëtare, për krijimin dhe ofrimin e specialistëve në fushat e ndryshme, por edhe nevojën kombëtare për kërkues shkencorë, për mësimdhënie cilësore. <i>Referenca:</i> 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, neni 2, 3, 4; 51, 52, 56, 57 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB; 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” 2024 – 2025;
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet	Ky program përpiqet të krijojë, nxisë dhe mbështesë një kulturë akademike të besueshme. Përqasja e këtyre vlerave kombëtare

në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	brenda këtij programi studimi përcillen në filozofinë si është ndërtuar, në komunikimin që ky program studimi ofron ndaj tregut të gjerë, studentëve, bizneseve, etj. Ai synon të mbështesë vlerat e orientuara nga institucioni dhe hallkat drejtuese duke krijuar vlera akademike si bashkëpunimi dhe partneriteti të reflektuar si brenda departamentit, midis stafeve dhe strukturave drejtuese, midis stafit dhe studentëve apo midis vetë fakultetit, studentëve dhe strukturave të administratës vendore e qendrore si dhe komunitetit të biznesit dhe të gjithë aktorëve të interesuar. Ky reflektim vjen nga konsultimi me dokumentat strategjike të institucionit, por edhe departamentit, si në vijim: <i>Referenca:</i> <i>1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 2, 3</i> <i>2.2 Rregullore e org të veprimtarisë mësimore e shkencore e FB</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Programi i studimit reflekton praninë e objektivave të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Këto qëllime dhe objektiva janë në përputhje me qëllimin dhe misionin e IAL dhe fokusohen tek fusha e agroturizmit, si kombinim i aftësive dhe njohurive në fushën e bujqësisë dhe në atë të turizmit, duke e kombinuar me nevojat e tregut të gjerë, në këto fusha. <i>Referenca</i> <i>1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit 2022-2027, pika 12;</i> <i>1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 2, 3;</i> <i>1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë;</i> <i>2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB;</i> <i>2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit	Institucioni është në përpjekje të vazhdueshme që përmes këtij programi studimi të përafrojë nevojat lokale dhe kombëtare për profesionistë në fushën e bujqësisë dhe turizmit, sidomos për sektorin e agroturizmit si një sektor prioritar, me potencialet njerëzore të ofruara përmes këtij masteri. Në ofrimin e këtij programi synimi themelor i shprehur në dosjen e aplikimit të

mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	programit dhe dosjen për riorganizimin e programit është paraqitur dhe në objektivat formuese të programit të studimit. Pasja e një programi të tillë brenda këtij departamenti, jo vetëm që fuqizon departamentin, zgjeron shtrirjen e tij në më shumë fusha, por përputh të gjithë filozofinë e njësisë (departamentin) ndaj nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe lokal, duke mundësuar këtë qëllim, por edhe mbështetur të gjithë institucionin në arritjen e këtij synimi. Programi përputhet me objektivat që parashtrohen në strategjitë kombëtare si: Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021 – 2026 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 - 202325 Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024 – 2030 Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 - 202727 <i>Referenca:</i> 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm“ 2024 – 2025; 12.Strategjia Kombëtare e Arsimit të Lartë 2021 – 2026; 12.3 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023; 12.4 Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024 – 2030; 12.5 Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 – 2027;			
Konkluzione	UNIKO ofron programe studimi në përputhje të plotë me orientimet strategjike kombëtare dhe drejtimin e zhvillimit jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivel rajonal dhe lokal. Programi i studimit i MP “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Agroturizmit” ofrohet në fushat e studimit të cilat janë gjithashtu në përputhje me fushat e fakultetit të Bujqësisë (FB) dhe departamentit përkatës të agrobiznesit (DA). Fusha studimore e turizmit gjithashtu mbështetet nga Fakulteti i Ekonomisë brenda UNIKO, si dhe marrëveshja me UBP.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësise kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UNIKO është një institucion me një përvojë shumëvjeçare në hapësirën akademike të arsimit të lartë në Shqipëri. I krijuar fillimisht si Instituti i Lartë Bujqësor (ILB) ai në vitin 1992 u njoh dhe zyrtarisht si Universiteti i Korçës, pikërisht për t'i shërbyer edukimit dhe zhvillimit ekonomik në zonën verilindore të Shqipërisë. Prioritetet strategjike të UNIKO përcaktohen në planin e zhvillimit strategjik, 2022-2027, ku janë pasqyruar dhe të sektorët strategjikë për të orientuar në hapjen dhe zbatimin e programeve të veta të studimit. Dokumentat e rregullores së FB, Planit strategjik të FB dhe rregullores së Programit të Studimit, i cili merr përsipër realizimin e këtij programi studimi, janë hartuar në bazë të statutit dhe rregulloreve të UNIKO. Të gjitha këto dokumenta që lidhen dhe ndikojnë direkt në cilësinë e realizimit të këtij programi studimi kanë marrë vendimin e miratimit të tij, pra, rregulloret kanë vepruar më parë vendimeve përfundimtare të miratimit përmes rregullores së aplikuar në dosjen e programit të studimit, duke munduar të sigurojë cilësinë e këtij programi që herët. Departamenti ndjek mjaft mirë politikën dhe strategjinë e institucionit dhe rrjedhimisht edhe të fakultetit të bujqësisë, të cilit i përket programi i studimit. Stafi akademik pranë FB dhe DA, si dhe ai i Departamentit të Marketingut dhe Turizmit pranë Fakultetit të Ekonomisë në UNIKO, janë një burim i rëndësishëm për zhvillimin e programit të studimit sipas standarteve kombëtare, duke pasqyruar më së miri kapacitetet akademike dhe profesionale të anëtarëve të të dy departamenteve, të mbështetur dhe nga Universiteti Bujqësor – Plovdiv. UBP. Ai është themeluar në vitin 1945, si qendër kombëtare e shkencës dhe arsimit bujqësor në Bullgari, me një pozicion të favorshëm, duke marrë edhe akreditimin institucional dhe notën më të lartë "Shumë mirë" nga Agjencia Kombëtare e Vlerësimit dhe Akreditimit. Referenca: 2.18 Shkresa për hapjen e "Institutit të Lartë Bujqësor"; 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli" 2.17 Listë e botimeve të stafit akademik 2.10.4 Marreveshje bashkepunimi e UNIKO me Univeristetin e Plovdiv, Bullgari https://www.ascal.al/sq/lista-e-ial/ial/universiteti-fan-s-noli-korce



Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	UNIKO synon qartë të ofrojë programe në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit. Lidhur me këto prirje sot turizmi është një nga sektorët më të rëndësishëm sa i përket ofrimit të mundësive për punësim dhe gjithashtu të ardhurave e ndikimit në sektorët e tjerë të ndërthurur përgjatë gjithë zinxhirit ekonomik. Stafi akademik i DA dhe Fakultetit të Bujqësisë, po ashtu si edhe stafi i Fakultetit të Ekonomisë, Departamenti Marketing-Turizëm (DMT) në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, janë së bashku në këtë program ndërdisiplinor me dy disiplina kryesore si bujqësia dhe turizmi, për të dhënë maksimumin bazuar në kapacitetin e tyre shkencor dhe akademik, sipas fushave të kompetencës. Gjithë stafi ka kompetencën e duhur sipas fushave përkatëse, duke mundësuar që programi i studimit të zhvillohet me sukses. Fusha specifike akademike e programit të studimit është në një linjë me fushat prioritare të zhvillimit të departamentit dhe Fakultetit, duke përkruar me fushën akademike të tij si dhe duke u bazuar në burime njerëzore të cilët janë të specializuar në fushat e bujqësisë, turizmit, dhe ekonomisë. Kodi i programit të studimit është: P71MP0419S/P71MP0419A/P71MP0419X)31 dhe përkon me klasifikimin e përcaktuar sipas sipas VKM 310 datë 11.05.2022 32. Referenca: 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” 2024 – 2025; 2.5.1 Praktika e plotë e dokumentacionit “Për Kodifikimin e Programeve të Studimit”; https://arsimi.gov.al/vendim-nr-310-date-11-5-2022-per-specifikimet-dhe-permbajtjen-e-kodifikimit-te-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise/
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore,	Lidhur me emërtimin dhe përputhshmërisë së tij me fushat e drejtimit akademik të institucionit, duhet të thuhet se emërtimi i programit Master Profesional në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Turizëm” paraqet orientimin e duhur në dy nga fushat me interes të institucionit, ku mendohet të ofrohen profesionistë në një fushë të ndërlidhur siç është bujqësia dhe turizmi. Si një Master Profesional Ndërdisiplinor me 60 kredite një vjeçar, ky është një master që paraqet Departamentin e Agrobiznesit si njësia bazë përgjegjëse për programin, në rregulloren e programit të studimit, pika 5, fq 8. Kjo

të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	njësi bazë përgjegjëse ka si fushë të saj kryesore akademike bizensin e lidhur specifikisht me agrikulturën, sikundër thuhet edhe në nenin 7, misionin e departamentit dhe nenin 8 objektivat strategjike të departamentit, ku agrobiznesi është fjala kyçe e lidhur me kapacitetet njerëzore që përpiqet të ndërtojë ky departament. Rrjedhimisht edhe agroturizmi, si një sektor i lidhur me bizneset bujqësore dhe zhvillimin agro/rural të rajonit është fushë e lidhur me fushën akademike të departamentit. Plotësimin me fushën e turizmit, programit ja jep edhe bashkëveprimi i ngushtë me Fakultetin e Ekonomisë dhe specifikisht me DMT. Referenca: 2.3 Rregullore e njësisë bazë 2.5.1 Praktika e plote e dokumentacionit për kodifikimin e programit të studimit
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky nuk është rasti këtij programi, pasi Menaxhimi i Qëndrueshëm në Agroturizëm, sikundër u argumentua në kriterin më sipër është brenda fushës akademike të njësisë bazë, e për më tepër tërësisht i lidhur me fushat kërkimore e studimore të UNIKO. E megjithatë, vlen të theksohet se ngritja e këtij programi është fuqizuar edhe më tepër nga bashkëpunimi me stafin e Departamentit të Turizmit i Universitetit të Plovdiv, të kualifikuar në fushat e bujqësisë, turizmit dhe të ekonomisë. Referenca: 2.3 Rregullore e njësisë bazë 2.5.1 Praktika e plote e dokumentacionit për kodifikimin e programit të studimit.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Momentalisht, duke qenë dhe një program relativisht i ri studimi, institucioni nuk ofron ende trajnime profesionale të mëtijshme për studentët, por studentët e vet mund të mbështeten nga trajnime të tjera profesionale të ngritura në fushën e agrobiznesit, në nëfusha dhe kurse që kanë ndërlidhje me fushën ekzistuese. Gjithashtu specifikisht në lidhje me këtë program, kurse të tilla janë në diskutim me kompanitë dhe bizneset partnere si dhe me organizimet e qendrës së formimit të vazhduar, e cila operon në nivelin e FB. Referenca 2.2 Rregullore e organizimit të veprimtarisë mësimore e shkencore e FB

	Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit dhe takimi me përgjegjësin e departamentit dhe dekanin.			
Konkluzione	Ky program përputhet me fushën kërkimore të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë në aspektin e fushës së agrobiznesit, duke konceptuar turizmin si një biznes i bazuar në fushën e agrikulturës. Por duke qenë se fusha e turizmit nuk mund të kufizohet vetëm në aspektin e një biznesi, por është një industri e mirëfilltë me shumë më tepër dinamika dhe njohuri të kërkuara, ka disa bashkëpunime të rëndësishme brenda dhe jashtë institucionit, që forcojnë fushën e studimit, sic është bashkëpunimi me DMT të FE si dhe bashkëpunimi me Universitetin e Plovdivit, Bullgari. Institucioni ka kapacitetet e mjaftueshme për ta ofruar këtë program studiminë fushat përkatëse akademike të bujqësisë dhe turizmit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Funksionimi i këtij programi studimi në departamentin e Agrobiznesit mbështetet nga institucioni jo vetëm nëpërmjet vetë departamentit, por dhe nëpërmjet bashkëveprimit me staf jashtë departamentit (Fakulteti i Ekonomisë, DMT) dhe jashtë institucionit. Ka një qasje aktive të njësive të tjera të funksionimit brenda universitetit në mbështetje të funksionimit të departamentit që ofron këtë program studimi. Konkretisht pedagogët e FE dhe DMT janë pjesë aktive e lëndëve me fokus tek turizmi dhe ka një përgjegjësi të ndarë në mënyrë të qartë midis drejtimit dhe pedagogëve, si dhe midis stafëve të departamenteve të fakulteteve të ndryshme, në gjithcka që lidhet me mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e programit. Mënyra e krijimit dhe propozimit të programeve si dhe ndarja e përgjegjësi për krijimin e syllabuseve, planit mësimor të programit, rregullores së programit etj., midis stafit dhe drejtimit si paraqitet në rregulloret e programit të studimit dhe rregulloret e FB si dhe në analizat e punës. Gjithashtu ka patur përgjegjësi në krijimin e syllabuseve dhe planit e programit mësimor të

	përcaktuara midis dy fakulteteve atij të FB dhe FE për lëndët përkatëse si dhe UBP, si një institucion i huaj që ka qenë mbështetje kryesore për këtë program studimi. Referenca: 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë mësimore Shkencore e FB, neni 5; 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë; 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore e FB për Vitin Akademik 2023-2024; 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	UNIKO, bashkëpunon në partneritet me shumë institucione akademike si dhe jo akademike ku përfshihen institucione lokale, rajonale, kombëtaree dhe ndërkombëtaree, duke u përfshirë në një numër të lartë projektsh dhe bashkëpunimesh me ta. Specifikisht FB dhe DA, kanë bashkëpunuar jo vetëm me insitucionet kërkimore/shkencore brenda dhe jashtë vendit, por edhe me aktorët e biznesit, sidomos edhe për këtë program studimi ku bashkëpunimi me bizneset ka vlerë për vetë njohuritë dhe aftësitë që duhet tu përcillen studentëve. Në lidhje me programin e studimit MP në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” është zbatuar Memorandumi i bashkëpunimit dhe Marrëveshja Akademike midit UNIKO dhe UBP, për të siguruar dhe mbështetur bashkëveprimin midis stafeve akademike të për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Referenca 2.10.1 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale; 2.10.2 Lista e Projekteve Kombëtare dhe Ndërkombëtare; 2.10.3 Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet UNIKO dhe Universitetit Bujqësor të Plovdiv; 2.10.4 Marrëveshje Bashkëpunimi Akademik ndërmjet UNIKO dhe Universitetit Bujqësor të Plovdiv
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute	Sa i përket praktikave profesionale për këtë program studimi partnerët dhe marrëveshjet e bashkëpunimit janë kryesisht në proces zhvillimi. Aktualisht, marrëveshjet e lidhura specifikisht për programin e studimit janë të pasqyryara në listën e marrëveshjeve me biznesin në mbështetje të praktikave profesionale.

kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Disa prej partneriteteve me institucione brenda vendit, si dhe me ato jashtë vendit, në rang institucional, i kanë shërbyer dhe departamentit, sidomos për aspektin e mobiliteteve, por patjetër edhe për pjesëne praktikave profesionale, sidomos marrëveshjet me biznese në fushën e buzjesisë dhe turizmit si dhe institucionet e pushtetit vendor të lidhura me këtë sektor. Këto marrëveshje kanë shërbyer për realizimin e praktikave edhe sipas vizitës në departament. Referenca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale; 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22, Pika 4,5,6; 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22, Pika 9;			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<i>Nuk rezulton që DA si njësia përgjegjëse për programin e studimit, të ketë hartuar raporte analitike vetëm specifike për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Por, ka një përmbledhje informacioni në analizën vjetore të departamentit, që gjithsesi flet kryesisht për marrëveshjet dhe analizat për mobilitetet apo përfitimet e studentëve nga bashkëpunimet kryesisht ndërkombëtare. Sa i përket vlerës së marrëveshjeve lidhur me praktikën mësimore apo cilat janë përfitimet e tjera, vetëm përmenden disa prej marrëveshjeve. Sugjerojmë që kjo analizë të jetë periodike dhe të paraqesë përfitimet dypalëshe të marrëveshjeve si dhe kontributet e UNIKO në marrëveshjet e bashkëpunimit.</i> Referenca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njesisë bazë			
Konkluzione	<i>Evidencat tregojnë lidhur me këtë standart se UNIKO, si një institucion i arsimit të lartë me përvojë të gjatë në fushën e programit të studimit, ka kapacitet të lartë për ndërtimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, si me institucionet e arsimit të lartë dhe ato akademike brenda e jashtë vendit, ashtu edhe me biznese dhe institucione të pushtetit lokal, rajonal dhe kombëtar. Këto kanë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm”, organizohet sipas ligjit, në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS, kjo sipas dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni. Programi është një Master Profesional 1 vjeçar me një total lëndësh prej 60 kreditesh. Bazuar mbi dokumentacionin për hapjen e programit të studimit, dokumentat e programit mësimor dhe planit mësimor, dhe rregullore e programit të studimit, ka një shpërndarje sipas ligjit e moduleve dhe e krediteve, gjithashtu duke parashikuar sipas standardeve orët fizike, orët në auditor (leksione, seminare, praktika mësimore) dhe ato të studimit individual, orë për praktikën në terren apo përgatitjen e temës së diplomës ka një ndarje sipas ligjit e moduleve konkretisht: A - Lëndë bazë: 5 kredite – 8,3% (Menaxhim Strategjik Agrobiznesi) B – Lëndët karakterizuese: 22 Kredite – 36,7% (Menaxhim i sipërmarrjeve agroturistike, Menaxhim i burimeve natyrore, Zhvillimi i Turizmit të qëndrueshëm, Cilësia dhe siguria Ushqimore, Inovacioni dhe zhvillimi rural). C – Lëndët ndërdisiplinore integruese: 18 kredite – 30% (Marketingu i Gjellbër, Dizajnimi I produkteve turistike, Menaxhimi I destinacioneve dhe marketinu I organizatave, Menaxhimi I destinacioneve turistike rurale, Parqet natyrore dhe menaxhimi I vizitorëve D – Lëndë plotësuese: 6 kredite – 10% - Praktika mësimore E – Detyrime përmbyllëse: 9 kredite – 15% - Temë diplome

	Referenca: 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB; 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm "2024 – 2025; 2.7 Plan i mësimor i programit të studimit.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Objektivat e përogramit të studimit në lidhje me formimin e njohurive, aftësive dhe shprehive specifike kanë për qëllim të orientojnë në disa drejtime kryesore si: • Drejtimin apo menaxhimin e sipërmarrje apo veprimtarive ekonomike ku ndërthuret bujqësia dhe turizmi; • Diversifikimin e prodhimit në fermë si dhe ofrimin e alternativave dhe shërbimeve shtesë, duke u bazuar në burimet që ata disponojnë; • menaxhimin e qëndrueshëm të aktiviteteve në fermë, stafit dhe turistëve; • Nxitjen e aktivitete mësimore e kërkimore dhe zhvillimin e bashkëpunimin me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e bujqësisë dhe turizmit, në interes të institucionit dhe nevojave të tregut të punës në nivel lokal dhe qëndror. Në kuadrin e këtyre objektivave program i studimit supozohet të arrijë një shumëllojshmëri specialitetesh në fushën e agroturizmit. Duke analizuar gjithashtu tërësinë e lëndëve dhe syllabuseve të programit të studimit mund të thuhet se tentohet të arrihet kjo shumëllojshmëri nëpërmjet lëndëve në disa fusha prioritare si Menaxhimi strategjik, ai i burimeve natyrore, marketing I gjelbër, inovacioni dhe zhvillimi rural, cilësia dhe sigurtia ushqimore etj. Gjithashtu vihet re një kombinim i fushave me fokus bujqësinë dhe turizmin, por edhe fusha ndërdisiplinore. Referenca: 2.6 Plan i Mësimor i Programit të studimit 2024-2025 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në planin mësimor të programit të studimit përcaktohet ngarkesa në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse, përkatësisht me 6 dhe 9 kredite. Detyrimet përmbyllëse lidhen me provimin e diplomimit ose temën e diplomës. Sa i përket praktikës profesionale ajo konsiderohet me rëndësi të madhe në këtë program studimi për vetë natyrën e tij

	aplikative. Zbatimi në terren i praktikave për të përmbushur detyrimet e përshkruara në dokumentet e programit është themelor. Realizimi i praktikës profesionale mbështetet nga marrëveshjet e përmednura në standartet e pikës 1 si dhe në përpjekjet institucionale, sidomos përmes zyrës së karrierës për të ndërtuar marrëdhëniet e duhura dhe procesin e duhur me bizneset dhe institucionet përkatëse për kryerjen e praktikës së studentëve. Referenca: 2.7 <i>Plani Mësimor i Programit të studimit 2024-2025;</i> 2.10 <i>Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet për këtë program
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve,	FB ofron studime me kohë të plotë në programe studimi të ciklit të dytë (MP). Forma e organizimit të studimeve në FB paraqitet në

pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	rregulloret e institucioni, rregulloren e FB dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Baza është organizimi në semestral Brenda vitit akademik me nga 15 javë. Për strukturën e vitit akademik ndiqet udhëzimi përkatës i MAS. Sa i përket kriterëve dhe procesit të pranimit në programet e ciklit të dytë të studimit MP në FB, këto zbatojnë Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit, si dhe rregulloren të njësisë kryesore dhe atë bazë. Kriteret për pranimin e studentëve në programet e ciklit të dytë të studimeve lidhen me përfundimin me sukses ciklin e parë të studimeve, pa patur ndonjë kriter të veçantë, përveçse atyre që përcakton ligji. Ciklin e dytë të studimeve në FB mund ta ndjekin edhe student të huaj si dhe në rastet kur ata kanë përfunduar një program tjetër të ciklit të dytë, duke paguar tarifën përkatëse me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Kriteret shtesë të pranimit pasqyrohen në rregulloret e njësisë bazë. Referenca: 2.15 <i>Struktura dhe Organigrama e UNIKO (Viti Akademik 2024-2025);</i> 2.2 <i>Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB;</i> 2.3 <i>Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesi</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit MP MQA konsiderohet si unik nga vetë institucioni duke iu referuar RVB. Por GVJ gjykon se mund të ketë programe në të njëjtën fushë studimi, ndoshta jo me të njëjtën emërtesë, sikundër menaxhimi i turizmit rural në UBT apo programe të ngjashme, të cilat UNIKO dhe DA duhet t'i shqyrtojë për disa arsye dhe synime kryesore. Nëse një IAL dëshiron të ketë programe që ta diferencojnë në fusha specifike, duhet të analizojë dallimin me të gjitha programet e studimit të cilat kanë një potencial për pika të përbashkëta. Sa i përket ngjashmërisë së paku 70% përderisa nuk janë programe me të njëjtën emërtesë, kjo nuk u jep mundësinë studentëve për lëvizje të brendshme në këto programe, ose kjo lëvizje do të shoqërohej patjetër me ekuivalentimin e programeve përkatëse. Pra kjo përqindje nuk duhet të jetë e aplikueshme në këtë rast. 2.7 <i>Plani Mësimor i Programit të studimit 2024-2025;</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria	Program i ciklit të dytë MP MQA, është një program studimi me kohë të plotë, i cili ofrohet nga Departamenti I Agrobizneist pranë Fakultetit të Bujqësisë, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (UNIKO) duke u regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe

përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me numër unik identifikimi. Programi I studimit të ciklit të dytë të studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” është I kodifikuar sipas klasifikimit të VKM 310 datë 11.05.2022. dhe konkretisht kodi I tij është: P71MP0419S/P71MP0419A/P71MP0419X Referenca: 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, neni 56; 3.23 Vërtetim i QSHA nr. 2626/11 Prot; datë 16.07.2024 “Për Regjistrimin në Regjistrin Shtetëror të Diplomave”; https://arsimi.gov.al/vendim-nr-310-date-11-5-2022-per-specifikimet-dhe-permbajtjen-e-kodifikimit-te-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise/
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program është pikërisht një program i tillë, që ka ardhur si rrjedhim i bashkëpunimit midis UNIKO dhe Universiteti të Plovdivit në Bullgari, UPB. Ky bashkëpunim është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazohet në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit. Kjo i ka dhënë një vlerë më të lartë vetë programit, si nga ana funksionale për shkak të bashkëpunimit me një institucion të rëndësishëm në hapësirën e institucioneve të arsimit të lartë, sa i përket fushës konkrete të studimit, po ashtu edhe nga ana formale, duke ndikuar në një imazh më pozitiv për shkak të bashkëpunimit me një institucion Europjan të arsimit të lartë.
Konkluzione	<i>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, sic janë statuti i UNIKO dhe rregullorja e institucionit ashtu edhe rregullorja e FB dhe programit të studimit. Këto përcaktojnë një sërë elementesh duke u nisur nga orientimet themelore në lidhje me përgjegjësitë e ndara sa i përket krijimit të programit të studimit, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe drejtimit, bazuar në legjislacionin për arsimin e lartë, ndarja e kategorive të lëndëve sipas VKM përkatëse, e deri tek kriteret e pranimit të kandidatëve, apo kodimin dhe përpjekjet e ndërtimit të një programi të përbashkët me një HEI europjan si UPB.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore në të cilën ofrohet ky program studimi është Fakulteti i Bujqësisë, i përbërë nga tre departamente, Agronomisë, Agroushqimit dhe Agrobiznesit. Si pjesë integrale e tij Departamenti i Agrobiznesit (DA), si njësi akademike bazë, ofron programin e studimit MP MQA. Ai përbëhet nga 7 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 2 Prof.As, 5 Dr 2023-2024 7 PAE 2024-2025 7 PAE/ 1PAK Stafi PAK është me gradën shkencore Prof. Dr. Duke iu referuar tabelave dhe konkretisht tabela 1 dhe 2 e shtojcave të këtij raporti. Ky departament ofron në total 4 programe studimi ndër të cilët njëri është program profesional, një bachelor dhe dy programe master. Numri i stafit, organizimi sipas strukturës me përgjegjësin e departamentit si dhe përbërja e stafit akademik sipas titujve janë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Gjithashtu pranë departamentit 1 (nje) pedagog me gradën Profesor Doktor, është angazhuar me kohë të pjesshme. Sa u përket standarteve të cilësisë mbi vlerësimin dhe akreditimin, njësia bazë, pra DA përmbush rregulloret përkatëse institucionale, duke përfshirë rregulloren e UNIKO dhe rregulloren e FB, psh në kreun VIII lidhur me sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, si dhe Manualin e cilësisë së UNIKO, pra në nivel institucional. Referencat: <i>1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>1.16 Manuali i cilesise se UNIKO</i> <i>2.2 Rregullore e org të veprimtarise mësimore e shkencore e FB</i>

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti përmbush kushtet lidhur me personelin ndihmës akademik për programin e studimit. Ai mbështet lidhur me praktikat mësimore, dokumentacionin etj. Ashtu sikurse FB në rregulloren e tij neni 23 përshkruan procesin e përfshirjes dhe marrjes në punë të kësaj kategorie personeli, DA, në rregulloren e tij në nenin 17, përcakton detyrat e personelit ndihmës akademik, duke përfshirë realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të universitetit në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. DA ka në përbërjen e tij një person të kategorisë personel ndihmës administrativ. <i>Referencat:</i> <i>1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>2.2 Rregullore e organizimit të veprimtarisë mësimore e shkencore e FB</i> <i>2.3 Rregullore e njësisë bazë</i> <i>2.4 4 Te dhena statistikore per stafin, studentet & programin e studimit</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në rregulloren e njësisë bazë ka një person të caktuar si Koordinator të programit të studimit, neni 14 ku jepen edhe detyrat e koordinatorit të programit. Gjithashtu ka një dokument me vendime të dekanit për përcaktimin e koordinatorëve për disa nga programet e studimit të departamentit. Megjithatë nuk mund të identifikohet koordinatori i këtij programi specifik. <i>Referenca:</i> <i>2.3 Rregullore e njësisë bazë</i> <i>2.11 Vendim departamenti per koordinatorët e programeve</i>			
Konkluzione	Njësia bazë përmbush kushtet ligjore për ofrimin e programit të studimit nga pikëpamja e organizimit strukturës dhe përbërjes së stafit akademik dhe ndihmës administrativ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Informacioni është bazë për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. UNIKO ka organizuar dokumentacionin bazë rregulloren, statutin, si dhe rregulloret e njësive kryesore dhe bazë në mënyrë të tillë që të jenë udhëheqëse për secalin element të programit të studimit. Gjithashtu, mënyra e transmetimit të informacionit është e tillë që legjislacioni në fuqi, përfshirë vendimet e udhëzimet vijnë nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, miraton rregulloret përkatëse dhe përcjell informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet. Gjithashtu Departamenti në rregulloren e tij sidhe me rregulloren e programit të studimit disponon informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e programit të studimit, lidhur me organizimin e vitit akademi në semestral, kohëzgjatjen, strukturën akademike, marrëdhëniet me stafin (të drejta e detyrime), me studentët (Të drejtat dhe detyrat e tyre, mënyrat e vlerësimit, praktikat mësimore, mënyra e diplomimit, etj), dhe me institucionet e tjera, të shprehura në statut, rregullore si dhe bazuar mbi rregulloren e programit të studimit. Të gjitha këto informacione të cilat bëhen me dije për studentët (vizita në institucion), shërbejnë më së miri për mirëadministrimin e programit të studimi. Referenca: Statuti i UNIKO 1.2 Rregullorja e UNIKO 2.2 Rregullore e organizimit të veprimtarisë mësimore e shkencore e FB 2.5 Rregullore e njësive bazë
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit të studimit MP MQA është dokumenti themelor i cili tregon: • lëndët e programit të studimit të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e simestra; • kreditet përkatëse • Ngarkesën mësimore të lëndëve • Orët në auditor dhe jashtë auditorit Plani mësimor, përmban edhe informacion mbi strukturën javore të elementëve të veprimtarisë akademike (javë mësimi, praktike, provime, diploma); shpërndarjen e krediteve sipas çdo disipline në:

	leksione /seminare/ushtrime /laboratorë etj; ngarkesën në auditor, ngarkesa javore në auditor; kreditet për çdo lëndë/modul etj. Në këtë program studimi ka një shpërndarje të barabartë të orëve në total në semestra me një total prej 750 orësh për cdo semestër dhe pak a shumë të balancuar në orë brenda dhe jashtë auditorit për cdo semestër, përkatësisht për semestrin e parë brenda auditorit 350 orë dhe për semestrin e dytë 321 orë, ndërsa për orët jashtë auditorit semestrin e parë janë 400 orë dhe semestrin e dytë 429 orë. Ndërsa shpërndarja midis orëve totale në auditor dhe jashtë auditorit është e ndryshme duke favorizuar orët jashtë auditorit, sidomos në semestrin e dytë, duke pasqyruar dhe tipin e veprimtarive praktikë dhe diplomë. Gjithashtu ka një shpërndarje midis leksioneve dhe seminareve duke pasqyruar dhe numrin e krediteve si dhe ndryshimin midis lëndëve të ndryshme specifike. Referenca: <i>2.7 Plan i mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve, si dhe transferimin dhe ekuivalentimin gjenden të rregulloren e organizimit të veprimtarisë mësimore e shkencore të FB, e cila në nenet specifike, 38, 50, 83 paraqet gjithë informacionin e duhur për studentët. Transferimi dhe ekuivalentimet paraqesin procedurë përkatëse të cilat u mundësojnë studentëve të transferojnë studimet nga dhe në programet e tjera të ngjashme të studimit. Duhet patur parasysh se ka pak mundësi të tilla për shkak se ky nuk është një program i ndeshur njësoj në hapësirën e Shqipërisë, por ka vecantitë e tij. Referenca: <i>2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe	Programi i studimit përmban gjithashtu dhe shoqërohet me programet lëndëore ose syllabuset për secilën lëndë. Syllabuset e lëndëve janë të ndërtuara sipas një modeli të përcaktuar paraprakisht bazuar mbi përvojën e programeve të mëparshme në UNIKO. Modeli i paraqitur i syllabuseve përmban informacionet e nevojshme për secilën lëndë, që rrjedhin nga plani mësimor, si emërtimin e lëndës, tipologjinë sipas kategorisë, orët e leksioneve dhe seminareve, numrin e krediteve, semestrin ku zhvillohet. Gjithashtu modeli përmban edhe kodin e etikës, përmbajtjen e

jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	lëndës, objektivat e të nxënit, temat si dhe shpërndarjen e orëve leksion dhe seminare për secilën temë. Por ka disa probleme që u evidentuan nga vizita në institucion e si rrjedhim u diskutua se ky model do të rishikohet nga institucioni si dhe do të përshtatet nga departamenti dhe stafi i programit. Duhet vënë në dukje se mungojnë syllabuset e lëndëve Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm, Menaxhimi i destinacioneve dhe marketingu i organizatave si dhe të lëndës me zgjedhje, praktikat e qëndrueshme dhe ekskluziviteti i mikpritjes. Gjithashtu në syllabuse vihet re se nuk janë literaturat për çdo temë sikundër e kërkon VKM 41. Një nga diskutimet e identifikuar gjatë vizitës në institucion i cili rezulton një aspekt formal i syllabusit, sipas përgjegjësit të departamentit është se ka një shpërndarje të paqartë lidhur me temat dhe numrin e javëve prej 15 të tilla, ku në pak raste rezulton se ka javë ku nuk ka shpërndarje me tema, kjo për shkak edhe të planifikimit të praktikave mësimore. Ky është një problem që duhet të gjejë zgjidhje për një paraqitje sa më të mirë të syllabusit, duke rishikuar modelin për t'iu përshtatur gjithashtu VKM 41. <i>Referenca:</i> <i>2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>2.8 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Duke qenë një program relativisht i ri studimi dhe i ndërtuar gjithashtu në bashkëpunim me UPB, përmbajtja e programit nuk ka pësuar ndryshime, pasi dhe nga vizita në institucion u vu re se ka një ndërrarësi sa i përket edhe lëndëve dhe programit midis dy institucioneve, duke qenë se UNIKO po përpiqet të përfitojë sa më shumë nga marrëveshja e bashkëpunimit. Gjithsesi në rregulloret e FB dhe Departamentit shprehet nevoja dhe procedura e përditësimit të vazhdueshëm në çdo fillim viti akademik në lidhje me lëndët dhe syllabuset e tyre. <i>Referenca:</i> <i>2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB</i> <i>2.3 Rregullore e njësive bazë</i> <i>Vizita në institucion, takimi me përgjegjësin e departamentit dhe takimi me pedagogët e programit.</i>

Konkluzione	<i>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme lidhur me të gjitha të dhënat për lëndët, kreditet, organizimin dhe strukturimin lidhur me ndarjen në semestra, orët në auditor dhe jashtë auditorit, kriteret e pranimit të studentëve në këtë program etj. Njësia bazë që ofron këtë program studimi është e orientuar për të bërë përmirësime të vazhdueshme në program, por në kufijtë edhe të marrëveshjeve institucionale që qëndrojnë në bazën e tij. Një problem i ngritur sa i përket këtij standarti është lidhur me modelin e syllabuseve, i cili duhet të përshtatet me VKM 41. Po ashtu duhet të përmirësohet plotësimi i tij në disa prej lëndëve, lidhur me literaturat për cdo temë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi PM MQA është një program i nevojshëm madje me vlera për vetë kushtet e tregut shqiptar i cili po zhvillohet shumë në aspektin turistik në përgjithësi, si dhe në disa komponente të tregut të turizmit të lidhura ngushtë me ushqimin dhe bujqësinë, sic është edhe agroturizmi. Formimi i specialistëve në këtë drejtim po bëhet një domosdoshmëri për tregun Shqiptar. Në këtë kuadër emërtimi i programit është i përshtatshëm duke patur parasysh edhe prirjet e dhjetëvjeçarëve të fundit për tu fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm, ku të dy sektorët si bujqësia edhe turizmi mund të ofrojnë oportunitete të konsiderueshme. Në këtë kontekst disa prej veprimtarive, lëndëve dhe praktikave janë me të vërtetë të gjetura dhe sigurisht bazohen dhe në përvojën shumëvjeçare të UNIKO si dhe në bashkëpunimin me UPB. Të tilla janë patjetër lëndë si Menaxhimi i sipërmarrjeve agroturistike, menaxhimi i burimeve natyrore, Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, Marketingu i gjelbër, Menaxhimi i destinacioneve turistike rurale, Inovacioni dhe zhvillimi rural, Parqet natyrore dhe menaxhimi i vizitorëve, Cilësia dhe siguria Ushqimore. Duke patur parasysh edhe syllabuset e lëndëve këto supozohet të ndërtojnë kapacitete dhe aftësi të studentëve nëpërmjet njohurive të thelluara si në aspektet menaxheriale, ashtu edhe në ato operationale dhe marketing lidhur me bizneset e agroturizmit.

	Megjithatë, duke i parë më në thellësi, në tërësinë e moduleve/lëndëve të programit ka edhe lëndë të cilat mund të kenë përsëritje si në tituj ashtu edhe në përmbajtje, psh, lënda “Menaxhimi i destinacioneve dhe marketing i organizatave” dhe “Menaxhimi i destinacioneve turistike rurale (lëndë të kategorisë C) janë dy lëndë, ku vetë specialiteti i menaxhimit të destinacioneve dhe njohuritë lidhur me të, bien në përsëritje. Mund të ketë një fokus në marketingun e destinacioneve dhe organizatave edhe në destinacionet rurale dhe të mendohet për një zgjidhje afatgjatë ku marketing i destinacioneve të lidhet me agroturizmin dhe të jetë i fokusuar në një lëndë, që patjetër fle tek fakulteti i ekonomisë që ka ekspertizën e duhur për këtë drejtim. Lëndë si Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm mund të rishikohen në emërtim pasi në kontekstin e këtij program mund të emërtohen menaxhim i turizmit të qëndrueshëm ose thjesht Turizmi i Qëndrueshëm (duke patur parasysh edhe literaturat bashkëkohore). Ndërkohë disa lëndë me zgjedhje si menaxhimi i kohës së lirë nuk është se japin kapacitete për një specialitet specifik, aq më tepër kur nuk janë edhe të kërkuara në këto program studimi. Kështu që duhet bërë një rishikim i kurrikulës, në terma të rifokusimit të lëndëve duke thelluar më tej njohuritë teorike dhe pastaj duke krijuar aftësi përmes ilustrimeve me raste konkrete p.sh. të destinacioneve rurale, por gjithnjë duke u fokusuar tek specialiteti i menaxhimit dhe marketingut të agroturizmit. Duke qenë se ka mungesa në evidence të programit (syllabusit) Menaxhim i destinacioneve dhe marketing i organizatave, kjo nuk na jep mundësinë të bëjmë një dallim konkret, por Lëndët më gjithëpërfshirëse si kjo kanë një mundësi më të madhe të japin njohuri dhe kapacitete të nevojshme në këtë program studimi. Për më tepër ka mungesa edhe në dy syllabuse të tjera, si ai I Menaxhimit të Turizmit të Qëndrueshëm dhe Praktikat e qëndrueshme dhe ekskluziviteti I mikpritjes. Referenca: <i>2.7 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>2.8 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	Shpërndarja aktuale e ngarkesës mësimore në semestra, shpërndarje e krediteve dhe orëve në auditor e jashtë auditorit, shpërndarja e lëndëve sipas semestrave dhe kategorive, është në përputhje me kërkesat ligjore. Por sa mundësoj ajo arritjen e objektivave të programit të studimit. Sigurisht që ky program kërkon ecjen bashkëkohore me prirjet aktuale dhe ato që parashikohen për të ardhmen lidhur me zhvillimin e dy sektorëve vitalë për ekonominë



rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.

shqiptare, por edhe atë rajonale dhe botërore, të cilët janë ndërthurur në fushën e agroturizmit.

Gjykojmë se lidhur me arritjen e objektivave formues të programit lëndët e vendosura këtu mundet ende të përmirësohen për të përmbushur edhe disa aftësi apo njohuri që mungojnë ose duhen thelluar edhe më tej.

Së pari duke qenë një programi i DA të FB sigurisht që ndërdisiplinariteti është i domosdoshëm. Me synimin për tu orientuar edhe nga biznesi shihet se në program ka edhe përsëritje si aspekti i destinacioneve (i sipërpërmendur). Ndërkohë që në lëndën e Destinacioneve dhe marketingut të organizatave, patjetër mund dhe duhet të trajtojë të përfshira dhe destinacionet rurale. Ndërsa marketingu i destinacioneve rurale mund të zëvendësohet duke dhënë lëndë që kanë lidhje më tepër me bujqësinë, ushqimin dhe konsumin ose proceset bujqësore dhe ndikimin tek vizitorët (agroturizmi nuk duhet konceptuar thjesht si kulinari, por si një proces pjesëmarrës i vizitorit në procesin e fermës).

Sugjerojmë që në të ardhmen të konsiderohet përfshirja në kurrikul e disa lëndëve që e pajisin studentin me aftësi dhe njohuri në fushat më të ngushta dhe me interes profesional sic janë Turizmi Rural, menaxhim akomodimi, shërbime të ushqimit dhe pijeve, rekreacionit (p.sh., guida dhe shtigje). Sugjerojmë që lënda Menaxhim i sipërmarrjes agroturistike, duhet përmirësuar duke ofruar më shumë njohuri konkrete lidhur ngushte me agroturizmin.

Së dyti, ndihet mungesa e njohurive dhe aftësive digjitale në këtë program, kur dihet se të gjitha tregjet botërore po përdorin teknologjitë e informacionit si një mbështetës i fuqishëm, në marketing, por në proceset e prodhimit dhe monitorimit, në biznes dhe tregti etj. Brenda programit duhet gjetur mundësi për vendosjen e të paktën një lënde ICT në agroturizëm, ose ose teknologjitë digjitale në ekonominë agroturistike (fermat agroturistike), mund të jetë lëndë me zgjedhje ose lëndë me një numër të ulët kreditesh, ose të paktën të kërkohet vendosja në një numër të konsiderueshëm lëndësh e temave lidhur me teknologjinë, të cilat mungojnë thuajse totalisht.

Referenca:

2.7 Plani mësimor i programit të studimit

2.8 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit

	<i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit dhe raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe mund të konceptohet si një pikë e fortë e programit. Edhe nga vizita në institucion, por edhe nga dokumentacioni në lidhje me marrëveshjet shihet se programi dhe departamenti së bashku me pedagogët e programit bëjnë përpjekje të lavdërueshme lidhur me vendosjen në praktikë të njohurive të. Marra nga studentët. Programi përmban ngarkesë të zgjeruar të praktikës mësimore-profesionale e cila realizohet semestrin e dytë. Janë gjithsej 150 orë praktikë mësimore/ profesionale) të cilat më pas kulmojnë në punën përgatitore për detyrimet përmbyllëse (diplomë ose provimin formimi). Megjithëse mundësitë e praktikave janë jo të shumëllojshme, programi shfrytëzon të gjitha marrëdhëniet e ndërtuara dhe planifikon t'i përdore ato efektivisht. Lëndët janë në përgjithësi në përputhje me profilin e programit dhe garantojnë formimin e duhur të studentëve. Por, disa mungesa të cilat u përmendën edhe në kriterin më sipër duhet të rishihen në kuadër të përmirësimeve të vazhdueshme cdo vit akademik, për tu përshtatur edhe më mirë. Këto mund të diskutohen edhe në rang të marrëveshjes me UPB, apo edhe institucione të tjera ndërkombëtare, duke qenë se përvoja e mirë për ndërtimin e këtij programi ka ardhur edhe si rrjedhim i bashkëpunimeve të ndryshme dhe mobiliteteve të stafit. Referenca: 2.7 Plani mësimor i programit të studimit 2.8 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit 2.9.1 Çertifikata pjesëmarrje e stafit akademik në bashkëpunime ndërkombëtare; 2.19 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik të Universitetit Hohenheim, Gjermani; 2.20 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik & Institutit kërkimor-shkencor CIHEAM; <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,	Objektivat kryesorë të programit të studimit paraqiten në dosjen e plotë të programit të studimit dhe janë konkretisht: • “Të përgatisë specialistë të kualifikuar dhe të aftë të përballen me sfidat e kohës për të drejtuar apo menaxhuar sipërmarrje apo veprimtari ekonomike ku ndërthuret bujqësia dhe turizmi;

transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

- Të përgatisë specialistë të kualifikuar dhe të aftë për të diversifikuar prodhimin në fermë, ofrimin e alternativave dhe shërbimeve shtesë, duke u bazuar në burimet që ata disponojnë;
- Të ofrojë njohuri specifike dhe aftësi të nevojshme për të krijuar një strukturë të sigurt për menaxhimin e qëndrueshëm të aktiviteteve në fermë, stafit dhe turistëve;
- Të nxisë aktivitete mësimore e kërkimore dhe të zhvillojë bashkëpunimin me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e bujqësisë dhe turizmit, në interes të institucionit dhe nevojave të tregut të punës në nivel lokal dhe qendror.”

Raportet midis formimit teorik dhe praktik në këtë program studimi mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit, sidomos ato lidhur me menaxhimin e sipërmarrjeve agroturistike, diversifikimin e prodhimit në fermë, ofrimin e shërbimeve dhe nxitjen e aktiviteteve mësimore e kërkimore për zhvillimin e bashkëpunimeve të frytshme. Procesi i praktikave mësimore, I kontrolluar në departament si dhe I dakortëzuar me institucione dhe ndërmarrje në bashkëpunim ndihmon dhe mbështet studentët, jo vetëm në krijimin e aftësive praktike, por edhe në krijimin e mundësive për punësim në të ardhmen. Nga vizita në institucion shohim se ka studentë besimplotë dhe optimistë në këtë drejtim, që për këto arsye kanë zgjedhur këtë program studimi duke ndërruar edhe drejtimin nga studime të mëparshme bachelor.

Sigurisht që përmirësimet në disa aspekte të njohurive specifike do t'i shtonin më shumë vlerë në aspektin e ndërtimit të atyre. Kapaciteteve njerëzore që do nevojiten nga tregu në vazhdimësi. Sa I përket transferimit të studimeve dhe mobilitetev ato zbatohen sipas rregullores së FB, ku ofrohet mundësia e ekuivalentimit në rast transferimi të studimeve si dhe mundësitë e njohjes së krediteve nga mobilitetet e mundshme. Në këtë program nuk ka evidenca që ka ndodhur kjo, por brenda fakultetit dhe universitetit ka eksperiencë pozitive.

Referenca:

2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB

2.13.1 Vendim Departamenti “Për ngritjen e komisionit të njohjes dhe ekuivalentimit të krediteve”

Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Bazuar në rregulloret përkatëse të institucionit dhe specifikuat edhe në rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore shkencore të FB, departamenti kontrollon në mënyrë të përvitshme përditësimin e vazhdueshëm, nëpërmjet firmosjes dhe ruajtjes së syllabuseve. Sa i përket literaturës bazë dhe asaj ndihmëse në disa prej syllabuseve ajo lë për të dëshiruar për sa i përket viteve të cilat hera herës janë edhe mbi 10 vite të vjetra. Gjithashtu në disa raste është përdorur si literaturë për cdo temë vetëm cikli i leksioneve të pedagogut dhe kjo nuk është e pranueshme sipas VKM 41. Departamenti duhet të bëjë një kontroll të imtësishëm të secilit syllabus për të garantuar futjen në to të artikujve shkencorë, librave e botimeve të huaja (book chapters etj) të kohëve të fundit për secilën lëndë, përvec kontributit të secilit pedagog me ciklin e leksioneve. <i>Referenca:</i> 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB 2.8 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive mbi burimet natyrore, menaxhimi strategjik burimet njerëzore, industrinë e turizmit, konceptet e mikpritjes dhe menaxhimit të sipërmarrjeve agroturistike, Marketingut të gjelbër, marketingut të destinacioneve rurale. Megjithatë, GVJ i qendron linjës së diskutimit të përmirësimit të përmbajtjes së lëndëve duke u përshtatur me emërtimet ose duke u përmirësuar, bazuar me kompetencat të cilat synohen të mbruhet tek studentët e programit, si në trajtimin e kriterit 1 dhe 2 në këtë standard. <i>Referenca:</i> 2.7 Plani mësimor i programit të studimit 2.8 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Duke qenë një program i ciklit të dytë i Masterit Profesional, studenti nuk synon vazhdimin e mëtejshëm të studimeve, por punësimin. Nga marrëveshjet ekzistuese të institucionit dhe ku përfiton edhe ky program studimi, ka një orientim pozitiv për punësimin e studentëve. Gjithashtu zyra e Alumni dhe Karrierës bën një përpjekje në këtë drejtim. Gjithsesi DA I cili ofron këtë program studimi, duhet të nxisë edhe më tepër kontaktet dhe bashkëpunimin midis operatorëve të sektorit privat nga njëra anë, dhe departamentit

	në anën tjetër, nëpërmjet formave më aktive për nxitjen e mëtejshme të punësimit të studentëve, përtej zhvillimit nga ana e tyre të praktikave profesionale. <i>Referenca:</i> 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njesisë bazë; Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit, takimi me zyrën Alumni dhe karrirës.			
Konkluzione	Në tërësi duhet thënë se programi garanton përmbushjen e objektivave të formimit të studentëve, jep njohuri dhe dije për krijimin dhe formimin e aftësive që do të mbështesin punësimin e studentëve, dhe ka një raport të përshtatshëm midis njohurive teorike dhe atyre praktike. Megjithatë ka disa hapësira për përmirësim në lidhje me mbivendosje apo përsëritje të koncepteve në lëndë specifike, si dhe mungesa kryesisht në lidhje me aftësitë dhe njohuritë e teknologjisë së informacionit si pjesë e rëndësishme e menaxhimit të sipërmarrjeve si në bujqësi ashtu edhe në turizëm në ditët e sotme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi, sic edhe u tha është ndërtuar në bashkëveprim me institucionet partnere, pra ka marrë gjithë hapësirën e mundësive për të përfutur nga një institucion me vlera akademike dhe praktike në fushën e studimit sic është UPB. Kjo e avantazhon programin në tregun e punës, nëse do të promovohet sic duhet dhe do të dijë të nxjerrë në pah dallimin nga programe të tjera. Por, aktualisht përmes vizitës në institucion kuptuam se nuk ka marrëdhënie konkrete lidhur me programin e studimit, me operatorët në treg për të realizuar ndryshime apo përmirësime të nevojshme të kurrikulës, bazuar në nevojat e tregut të punës. Ka disa marrëveshje bashkëpunimi, por që nuk evidentohet se përdoren për këtë qëllim, por vetëm për qëllimet e praktikave, kjo edhe për shkak të një program relativisht të ri. I vetmi studim I parë i tregut të punës merr informacion mbi nevojat e tyre për aftësitë e njerëzve të

	kërkuar nga ndërmarrjet e agrotobiznesit dhe agroturistike aktualisht, gjë që është positive për përmirësime të programit edhe psh në aspektin e teknologjive digjitale të cilat janë përshkruar si aftësi të nevojshme nga studimi I tregut. Por nuk ka ende studime pas diplomimit, për të marrë statistika se sa është kërkesa për stafe në këto ndërmarrje dhe çfare tip stafi kërkojnë ata, cilat janë specialitetet që kërkohen të lidhura me aftësitë përkatëse. Gjykojmë se duhet të merret më tepër informacion i nevojshëm nga tregu i punës me synim punësimin e mëtijshëm të të diplomuarve. Referenca: 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB. 3.12 Studim Tregu për Programin e Studimit "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm".
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në UNIKO funksionon rrjeti i cilësisë, me përgjegjësinë e ngritjes, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë. Sistemi I brendshëm I cilësisë patjetër vendos në fokus edhe pyetësorët e studentëve, nëpërmjet realizimit të të cilëve cdo semestër mund të evidentohen disa prej mendimeve të tyre dhe të analizohen në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Pjesë e këtyre diskutimeve janë gjithashtu edhe diskutimet me studentët e programit të studimit dhe strukturat e tyre. Rregullorja e UNIKO paraqet të drejtat e studentëve për tu përfaqësuar në organet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Nga ana tjetër nga vizita në institucion, takimi me studentët u vu re se ka komunikim të vazhdueshëm midis stafit të programit dhe studentëve, për të evidentuar elemente që mund të përmirësohen, kënaqësitë apo problematikat me të cilat ata përballen. Në takim ka prezencë edhe të studentëve që kanë përfunduar studimet dhe punojnë aktualisht me projekte të filluara që nga koha e shkollës, gjë që ndikon pozitivisht në orientimin më të mirë të programit në të ardhmen dhe evidenton mbajtjen e marrëdhënieve me alumni të programit. Referenca: 3.7.1 Raporti Institucional i Vlerësimit të Brendshëm UNIKO (Relacion): 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët: Vizita në institucion, takimi me studentët e programit
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit	Duke qenë se ky program studimi është i ri dhe është ndërtuar bazuar mbi një marrëveshje ndërkombëtare, kjo ka sjellë edhe si pikë të fortë për programin përshtatjen me zhvillimet e fundit në

në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	fusha të ndryshme. Gjithashtu institucioni përfiton edhe nga marrëveshjet e tjera që ka si me institucione të arsimit të lartë, ashtu edhe me institucione të tjera brenda vendit, publike e private. Këto marrëdhënie nuk është se janë materializuar në lidhje me përmirësimet, për shkak të kohës së shkurtër të programit, por ato duhen shfrytëzuar pikërisht në këtë moment për përmirësimet e nevojshme përgjatë procesit pas akreditimit. Referenca: 2.10.3 Memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Plovdiv, Bullgari 2.10.4 Marrëveshje bashkëpunimi e UNIKO me Universitetin e Plovdiv, Bullgari 3.12 Studim Tregu për Programin e Studimit "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm"			
Konkluzione	Në këtë program studimi është përfituar nga marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe nga strukturat e mirëndërtuara brenda universitetit për standartet e cilësisë, në mënyrë që të merret mendimi i studentëve dhe partnerëve të ndryshëm. Në të ardhmen duhet të ketë një përfitim edhe më të fokusuar tek aktorët e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit MP MQA paraqet objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në rregulloren e programit të studimit, në pikën 3 lidhur me objektivat formuese, ku përfshihen formimi i specialistëve të aftë në sektorin e agroturizmit dhe zhvillimit rural në përgjithësi, me kapacitete menaxheriale, inovative, me vizion në kontributin për politikat rurale dhe agroturistike, me këndvështrime të reja në kuadrin e përvojës dhe koncepteve europjane të zhvillimit të turizmit. Në këtë këndvështrim, këto objektiva janë në përputhje me objektivat madhorë të institucionit të shprehura në rregulloren e institucionit dhe statutin si dhe në planin strategjik të tij. Objektivi kryesor është formimi i specialistëve të aftë për tregun e punës në të gjitha fushat me prioritet strategjike për vendin, duke u fokusuar në kualifikimin

	e vazhdueshëm, krijimin e hapësirave dhe mundësive të zhvillimit kulturor dhe social si dhe nxitjen e punës kërkimore shkencore. <i>Referenca:</i> <i>1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Kreu IX.</i> <i>1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>1.3 Plan i Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027,</i> <i>2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025,</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	DA, njësia bazë që ofron programin e studimit bazuar në legjislacion dhe rregulloren e saj dhe të institucionit, kryen edhe veprimtari si : nxitja, programimi, bashkërendimi, zhvillimi, organizimi dhe administrimi i veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimore-shkencore, përcaktimi i fushave prioritare të kërkimit shkencor, aplikimi për fonde në programe të ndryshme kërkimi kombëtare ose ndërkombëtare, bazuar në prioritetet e kërkimit, etj Njësia bazë gjithashtu vendos për fushat kërkimore dhe listën e temave studimore për studentët që diplomohen me temë diplome, në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe objektivat e njësisë. Liria akademike në përcaktimin e fushave të kërkimit dhe nxitjes së kërkimit sipas fushave zbatohet sipas rregulloreve të departamentit, FB dhe UNIKO, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Referenca: <i>1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Kreu IX.</i> <i>1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit;</i> <i>2.22 Vendim Departamenti "Mbi miratimin e fushave të kërkimit dhe temave të diplomës".</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Pavarësisht se ky program studimi ka një karakter profesional, studentët nxiten dhe motivohen për tu përfshirë në projekte dhe aktivitete kërkimore. Ata i realizojnë përmes punimeve në detyrat e kursit dhe punët e tjera përgjatë semestrit për të marrë edhe vlerësimet semestrale. Disa prej tyre realizojnë kërkime në temat e diplomave sipas kritereve të përcaktuara për studentët që do të realizojnë temë diplome. Nga vizita në institucion një student alumni i programit është përfshirë në projekt studimor përgjatë studimeve dhe po punon aktualisht në këtë projekt. DA organizon edhe takime me pjesëmarrje të studentëve, 2 herë gjatë vitit akademik, me institucione dhe organizata publike dhe private, për t'i nxitur ata në punë kërkimore në kuadër të

	bashkëveprimin me sektorin, si dhe për pjesëmarrjen në mobilitete të ndryshme. Vlen të përmendet se këto organizime janë kryesisht në kuadër të të gjitha programeve të studimit të ofruara nga DA dhe FB, por në të ardhmen duhen nxitur takime specifike të lidhura me agroturizmin dhe me këtë program studimi. <i>Referenca:</i> <i>2.6 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025,</i> <i>3.10 Praktika e organizimit të tjezave të rumbullaketa me sek privat</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Sa i përket mekanizmit financiar të mbështetjes së aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, UNIKO është në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe ligjit të arsimit të lartë. UNIKO ka një rregullore financiare dhe zbaton procedurat e miratimit të buxhetit nga Bordi i Administrimit dhe Senati akademik. Hartimi i projekt buxheteve fillon që nga njësia bazë, e cila shpreh nevojat e saj për buxhet të cilat transmetohen sipas procedurave përkatëse dhe niveleve drejtuese, duke u inkuorporuar në buxhetin institucional. Analizat vjetore të institucionit paraqesin realizimin e buxhetit edhe në kontekstin e kërkimit shkencor Institucioni ka përfituar fonde edhe nga përfshira në projekte ndërkombëtare të cilat listohen në analizën vjetore (projekte të aplikuara dhe projekte të fituara) dhe shprehen edhe nga takimi në institucion me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit. Por sa i përket buxhetit të fokusuar në realizim të aktiviteteve studimore e kërkimore në funksion të DA si njësi bazë që ofron programin e studimit, duhen evidentuar më mirë projekte të lidhura konkretisht me DA apo me programin e studimit. Pedagogë të ndryshëm të programit të studimit kanë përfituar nga bursat e mobiliteteve apo janë pjesëmarrës në projekte kombëtare e ndërkombëtare të punës kërkimore. Duhet evidentuar një lidhje midis njësisë bazë dhe mbështetjes financiare konkrete të punës kërkimore të saj, në terma të analizës vjetore të departamentit dhe FB, kur thuhet se ka një mbështetje të shtuar nga institucioni për punën kërkimore të stafit akademik.
	<i>1.8.1 Rregullore Financiare e UNIKO;</i> <i>3.15 Praktika e miratimit të buxhetit UNIKO;</i> <i>2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare i UNIKO 2022-2023;</i>

	3.8 Analiza vjetore e veprimtarise se njesisë bazë			
Konkluzione	<i>Programi i studimit paraqet në dokumentat kryesore të rregullores dhe në evidenca të tjera fushat e kërkimit shkencor. Bëhen përpjekje të mira për nxitjen e studentëve në pjesëmarrjen në kërkime shkencore si dhe për rritjen e buxhetimit të kërkimit shkencor kryesisht përmes rritjes së fondeve nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare e ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamentit të Agrobiznesit, ka kontribuar me stafin e kualifikuar të saj si dhe me përvojë në projektet kombëtare e ndërkombëtare, për rritjen e kapaciteteve të institucionit në aplikimin e projekteve kërkimore. Disa prej projekteve të fituara në rang institucioni, janë pjesë e bashkëpunimit që departamenti ka me Qendrën Ndërdisciplinore të Kërkimit Shkencor pranë Rektoratit. Nga analiza vjetore e veprimtarisë së DA gjithashtu identifikohen 3 projekte kërkimore shkencore si pjesë e bashkëpunimit me Institucionin dhe Institucione të tjera partnere në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Referenca:</i> 2.10.2 Lista e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare 3.8 Analiza vjetore e veprimtarise se njesisë bazë
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Personeli akademik i Departamentit të Agrobiznesit, është i angazhuar në punën kërkimore si dhe në kualifikimet e veta përmes bashkëpunimeve me institucione kombëtare e ndërkombëtare. Gjithashtu ky program studimi është bërë i mundur në sajë të projektit të fituar ERASMUS+, në rastin konkret me Universitetin Bujqësor të Plovdiv. Anëtarët e stafit akademik DA janë angazhuar gjithashtu në publikime shkencore në konferenca të njohura ndërkombëtare në bashkëpunim me staf akademik të universitetit Nuertingen-Geislingen (Gjermani) dhe Universitetit të Savonias (Finlandë).

	2.10.2 <i>Lista e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare</i> 2.9.1 <i>Çertifikata pjesëmarrjeje e stafit akademik në bashkëpunime ndërkombëtare</i> 2.9 <i>Jeteshkrimet e stafit akademik</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	DA merr pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve shkencore në rang institucioni dhe gjithashtu pedagogët e departamentit dhe programit kanë angazhim aktiv në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare të cilat mbështesin arritjen e objektivave specifike të programit. Gjithashtu nga analiza vjetore e institucionit shihet se ka pjesëmarrje të studentëve në konferenca studentore apo aktivitete të ndryshme kërkimore. DA nuk ka organizuar vetë apo në kuadër të FB konferenca me tematika të lidhura me programin e studimit. <i>Referenca</i> 2.4 <i>Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare i UNIKO 2022-2023</i> 2.9 <i>Jeteshkrimet e stafit akademik</i> 3.8 <i>Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Ky program studimi kontribuon duke formuar profesionistë në fushën e agroturizmit duke krijuar mundësi në punësimin e studentëve, në pozicione dhe sipërmarrje e organizata të ndryshme si: Menaxherë në njësi të ndryshme agroturistike, administratorë dhe specialistë në institucionet publike në mbështetje të zhvillimit të turizmit në zonat rurale dhe specialistë në OJF të ndryshme të cilat angazhohen në implementimin e projekteve me fokus turizmin. Zhvillimi i praktikës mësimore-profesionale pranë institucioneve që i përkasin sektorit publik dhe privat, (bazuar në marrëveshjet e nënshkruara midis FB dhe përfaqësuesve ligjorë të këtyre njësive), apo internshipet e zhvilluara në njësi turistike, krijojnë mundësi të mira për studentët për të aksesuar në tregun e punës. Bazuar në raportet periodike të gjurmimit të studentëve, mbi 85% e studentëve të sapodiplomuar, janë punësuar në institucione publike ose sipërmarrje të sektorit privat që zhvillojnë aktivitete ekonomike në sistemin e agrobiznesit. Duhet bërë më shumë në lidhje me specifikën e sektorit të agroturizmit, i cili patjetër që është edhe më i specializuar. <i>Referenca</i>

	2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale; 2.21 Gjurmimi i Ecurisë së Punësimit (Alumni);			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Pranë UNIKO është ngritur “Qendra Profesionale e Formimit të Vazhduar”, e cila ka për synim ofrimin e kualifikimeve përgjatë zhvillimit të profesionit dhe po punon për ngritjen e programeve të kualifikimit të vazhduar edhe në këtë program studimi. Në kuadër të kësaj përpjekjeje, ka kontakte me aktorët përkatës të tregut për të marrë edhe sygjerimet përkatëse për këto kualifikime si dhe për programin. <i>Referenca:</i> <i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi pasi ky nuk është një profesion i rregulluar.			
Konkluzione	<i>DA ka një angazhim pozitiv në pjesëmarrjen në punën kërkimore shkencore , si të stafit të programit të studimit ashtu edhe të departamentit në funksion të arritjes së objektivave të programit. Nkohuri të thelluara mund tu ofrohen studentëve bazuar pikërisht në punën kërkimore shkencore në fushat e lidhura edhe falë ndërkombëtarizimit i cili është baza e këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në këtë program studimi, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksione, seminare, projekte/detyra (pjesë e vlerësimit të lëndës), praktika profesionale. Në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve përcaktohen orët totale për çdo lëndë dhe të ndara sipas leksioneve dhe seminareve si dhe orëve të projekteve për çdo lëndë. Kjo krijon një ide të qartë për studentët lidhur me punën e tyre brenda dhe jashtë auditorit. Gjithashtu është përcaktuar praktika profesionale si lëndë e kategorisë D me 6 kredite, sikurse është cituar dhe më sipër. Bazuar në kreditet që ka secila lëndë, përcaktohet edhe ndarja e orëve mësimore në auditor, në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratore për çdo disiplinë, orët jashtë auditorit të cilat përcaktojnë punën e studentit nëpërmjet detyrave dhe sasisë së punës individuale të kërkuar. Ky program studimi, për 1 vit studimi, ka një shpërndarje të tillë të ngarkesës në: Leksione = 365 orë mësimore, Seminare = 156 orë mësimore, Praktikë Mësimore = 150 orë mësimore dhe në total 671 orë mësimore në auditor dhe 829 orë jashtë auditori. Bazuar në rregulloren e FB dhe rregulloret e institucionit, në përfundim të secilës lëndë/modul parashikohet vlerësimi nëpërmjet provimit. Kontrolli i dijeve realizohet përveçer përmes provimit edhe nëpërmjet instrumentave të vlerësimit si: testimet me shkrim dhe me gojë, ese, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantime dhe teza diplome. <i>Referenca:</i> 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, 2.7 Plani Mësimor i Programit të studimit 2022-2025;
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të	Duke analizuar syllabuset e lëndëve, shihet përfshirja e aspekteve të rëndësishme bazë të një syllabusi, por përveç sqarimit të temave dhe ndarjes në forma klasike të trajtimit të seminareve, nuk

studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	pasqyrohet në syllabus nxitja e formave ndërvepruese me studentin apo informacion më i detajuar mbi çfarë do të përfshijnë, si punët praktike apo detyrat/ projektet etj. Syllabuset krijojnë më tepër një standartizim në pasqyrimin e formave dhe mënyrave të mësimdhënies/nxënies dhe nuk paraqesin forma alternative që t'i përgjigjen diversitetit dhe nevojave të studentëve. Nga vizita në institucion dhe intervista me pedagogët e programit ata përmendin format klasike të mësimdhënies si dhe përfshijnë studentët në projekte të punës në grup apo dhe individuale. Gjithashtu ata zbatojnë format e mësimdhënies të mbështetura nga teknologjitë digjitale, si dhe të kombinuara me format e mësimdhënies në distancë. Referenca: 2.10.4 Marrëveshje Bashkëpunimi Akademik ndërmjet UNIKO dhe Universitetit Bujqësor të Plovdiv; 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025; 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	<i>Institucioni nuk ka ndonjë politikë specifike për rritjen e kapaciteteve të stafit lidhur me kompetencat didaktike, bëhet fjalë si për trajnime të vazhduara apo guida për rritjen e njohurive mbi metodat e reja në mësimdhënie dhe edukim, në arsimin e lartë, apo forma të tjera diskutimesh dhe debatesh brenda departamentit, forma të komunikimit me aktorët jashtë departamentit, alumni, apo dhe studentët aktualë për të identifikuar metodat më të mira dhe përmirësim të vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies.</i> Megjithatë vërehen disa përpjekje në aspektin e marrëveshjeve të krijuara institucionale ku krijohen disa kushte për nxitjen e stafit për përmirësimin e kompetencave didaktike. Pjesëmarrja e stafit në projekte kombëtare e ndërkombëtare, rrit kontribuon në këtë drejtim. Pozitivisht kontribuon edhe mbështetja e institucionit përmes ofrimit të infrastrukturës teknologjike për realizimin e mësimdhënies. Referenca: 2.19 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik të Universitetit Hohenheim, Gjermani; 2.20 Model i hartimit të një moduli, në bashkëpunim me staf akademik & Institutit kërkimor-shkencor CIHEAM;

	<i>2.9.1 Certifikata Pjesëmarrje e Stafit Akademik në Bashkëpunime me Institucione Ndërkombëtare;</i> <i>2.9.1 Certifikata Pjesëmarrje e Stafit Akademik në Bashkëpunime me Institucione Ndërkombëtare;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Kompetencat e stafit akademik për të realizuar me sukses procesin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor janë të evidentuara përmes jetëshkrimeve të stafit. Pjesa e konsiderueshme e stafit akademik kanë gradat dhe titujt përkatës si dhe kane realizuar punë kërkimore të lidhura me fushat përkatëse, gjë që krijon mundësinë për transmetimin e njohurive dhe kompetencave tek studentët. Syllabuset gjithashtu përmbajnë informacionin e duhur për të evidentuar njohuritë e transmetuara për studentët. Në disa prej tyre evidentohen edhe tematika për seminarët, por duhen evidentuar më në detaje metoda alternative, përfshirja e rasteve studimore, temat e diskutimit apo trajtimit analitik dhe kritik nga studentët. Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit u evidentuan se si nëpërmjet metodave të rasteve studimore apo nxitjes së bashkëveprimit në klasë në punën në grupe në projekte apo detyra, personeli akademik krijon mundësi për nxitjen tek studentët mendimin krijues, kritik dhe autonom. Nga takimi me studentët gjithashtu u evidentua mbështetja dhe orientimi që stafi u jep atyre për secilën lëndë, si dhe për mbarëvajtjen e studimeve në përgjithësi. <i>Referenca:</i> <i>2.8 Programet lendore të programit të studimit (syllabuset)</i> <i>2.9 Jetëshkrimet e stafit akademik</i> <i>Vizita në institucion: takimi me pedagogët e programit dhe takimi me studentët e programit të studimit.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia përgjegjëse, DA merr pjesë aktive në vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies nëpërmjet mbështetjes ndaj procesit nga njësia e sigurimit të Cilësisë. Vlerësimi realizohet periodikisht dy herë në vit nga studentët, por gjithashtu bëhen vlerësime të performancës nga departamenti përmes analizave të punës vjetore dhe në bashkëveprim me Fakultetin dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC). Informacioni nga pyetësorët e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor merret nga dekanati dhe përfshihet në analizat vjetore. Bazuar mbi rregulloren e FB, pedagogët në përfundim të

	vitit akademik japin një relacion të shkruar për organizimin e mësimdhënies duke evidentuar problemet dhe sugjeruar zgjidhje, si dhe në lidhje me procedurat e kontrollit të dijeve dhe rezultatet e marra. Rishikimet e kurrikulave duhet të bazohen në këto analiza dhe të dhëna të studentëve. Referenca: <i>3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i> <i>3.13 Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor;</i> <i>3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i> <i>3.7.1 Raporti Institucional i Vlerësimit të Brendshëm UNIKO (Relacion);</i> <i>3.4 Raport i kontrollit të ushtruar për dokumentacionin mësimor;</i> <i>3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në UNIKO nuk ka një strukturë të mirëfilltë jo thjesht për të promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, por për të testuar dhe eksperimentuar metoda të reja bashkëkohore si dhe për të trajnuar në mënyrë të vazhduar personelin akademik në përmirësimin e aftësive dhe kapaciteteve mësimdhënëse. Por UNIKO ka disa njësi dhe rregullore apo udhëzues që në funksionin e tyre kanë edhe nxitjen për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, kryesisht në mënyrë të tërthortë. E tillë është Drejtoria e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional apo edhe NJSBC, ku misioni kryesor i tyre është vlerësues, por në funksionet e tyre ato krijojnë në përfundim të procesit edhe mundësi për përmirësimin e stafit dhe për përfshirjen e metodave inovative. Kështu Drejtoria e Kurrikulave bashkëvepron me të gjitha njësitë dhe bashkërendon punën për të kontrolluar dhe monitoruar punën me kurrikulat, duke dhënë orientime se si dhe ku duhet të përmirësohen apo të rishikohen në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Në mënyrë të tërthortë, kanë ndikuar pozitivisht edhe projektet ndërkombëtare në këto mundësi për eksperimentimin e metodave apo mënyrave të reja në mësimdhënie dhe përmirësimin e kurrikulës. Referenca: <i>1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional,</i> <i>1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO;</i> <i>2.10.2 Lista e Projekteve Kombëtare dhe Ndërkombëtare</i>

Konkluzione	UNIKO në përgjithësi shfaq një nivel të kënaqshëm të garancive që jep për procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Megjithatë ka disa pika ku duhet punuar më tepër në këtë drejtim për përmbushjen e plotë të standartit, sic janë ngritja në një nivel më të lartë e shumëllojshmërisë së metodave inovative të mësimdhënies si dhe ndërtimi i strukturave përgjegjëse për eksperimentimin dhe trajnimin e stafit pedagogjik me këto metoda të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregulloret e programit të studimit, rregullore e FB si dhe rregullore e UNIKO përcaktojnë ndër të tjera edhe metodat e vlerësimit të njohurive të cilat përfshijnë vlerësimin e vazhduar, vlerësim të njohurive përgjatë semestrit si dhe vlerësimin përfundimtar, nëpërmjet provimit. Në vlerësimin e vazhduar hyjnë provimet e ndërmjetme dhe vlerësimi i aktiviteteve si seminare dhe projekte apo detyra. Të gjitha këto paraqiten për tu zbatuar edhe në syllabuset e programit të studimit. Ato bëhen transparente për studentët përmes njohjes së rregullores si në fillim të studimeve të tyre përmes takimeve prezantuese, ashtu edhe nëpërmjet botimit në Eëb-site. Syllabuset bëhen të njohura nëpërmjet prezantimit të tyre në fillim të semestrave përkatës. <i>Referenca:</i> 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, 2.3 Rregullore e Njësive Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” 2024 – 2025, 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) Vizita në institucion: takimi me pedagogët e programit dhe takimi me studentët e programit të studimit.



Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit përgjatë orës së parë të prezantimit të lëndës dhe syllabusit tek studentët. Gjatë takimit me studentët në institucion u vu re se ky proces ka ndikim pozitiv tek studentët dhe realizohet nga të gjithë pedagogët e lëndëve. UNIKO në përgjithësi, por edhe fakulteti i Bujqësisë dhe Departamenti i Agrobiznesit në vecanti bëjnë transparente për studentët metodat e vlerësimit dhe kjo jep një efekt pozitiv përgjatë procesit të dhënies së dijeve në vijimësi. Referenca: 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” 2024 – 2025, 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) Vizita në institucion: takimi me pedagogët e programit dhe takimi me studentët e programit të studimit.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve në të gjitha lëndët/modulet e këtij programi paraqitet në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabuset e lëndëve. Ato janë të shumëllojshme duke u dhënë kështu mundësi studentëve jo vetëm të tregojnë nivelin njohurive të marra përgjatë kurseve, por edhe të bëjnë transparence dhe drejtësi në vlerësim konform njohurive dhe aftësive të marra përgjatë realizimit të lëndëve/moduleve përkatëse. Referenca: 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” 2024 – 2025, 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) Vizita në institucion: takimi me pedagogët e programit dhe takimi me studentët e programit të studimit.
Konkluzione	Lidhur me testimin dhe vlerësimin e njohurive, rregulloret përkatëse të institucionit, të fakultetit , departamentit dhe

	programit të studimit japin shumë qartë dhe konform legjislacionit format dhe metodat e vlerësimit të dijeve, duke përdorur vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar, duke i bërë transparente për studentët në fillim të semestrit dhe duke u dhënë mundësi studentëve të vlerësohen në mënyrë sa më të drejtë dhe të paanshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Shtirja e vlerësimit dhe testimit të studentëve përgjatë vitit akademik shprehet në rregulloren e programit dhe syllabuset e lëndëve. Ato përmbushin kriterin e VKM 41 në këtë drejtim, duke paraqitur format e ndryshme të vlerësimit, të paraqitura me pikë e që përbëjnë vlerësimin e vazhduar (30% të pikëve të vlerësimit) dhe vlerësimin final (70% të vlerësimit total). Vlerësimi i vazhduar duke patur parasysh që lëndët janë ssemestrale përfaqëson punën e bërë nga studenti përbgjatë semestrit dhe është i përcaktuar qartë se c’pjesë të vlerësimit final do të përbëjë, në cdo syllabus të lëndëve. <i>Referenca:</i> 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” 2024 – 2025, 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në UNIKO ka disa vite që përdoret platforma CleanScore në bashkëpunim me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF), platformë e cila shërben për kodimin dhe leximin elektronik të testeve si dhe për transferimin në vlerësim në pikë, në mënyrë elektronike. Ky korrigjim i automatizuar ka shërbyer për të rritur transparencën në vlerësimin e studentëve. <i>Referenca:</i> https://www.cleanscore.al/

Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Syllabuset e lëndëve janë ndërtuar duke u bazuar në bazën ligjore në fuqi dhe tregojnë edhe mënyrën e vlerësimit me pikë dhe rregullin e konvertimit të pikëve në notë. Vlerësimi përfundimtar për secilën lëndë realizohet duke u bazuar tek syllabusi që merr parasysh vlerësimet gjatë semestrit dhe vlerësimin e provimit final të lëndës. Bazuar në rregulloren e organizimit të veprimtarisë në FB, provimi final mund të organizohet me shkrim, me gojë, ose në të dy format së bashku. Referenca: 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, nenet 53 dhe 54.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Duke u bazuar tek rregulloret e FB dhe departamentit si dhe rregullore e programit të studimit, format e ndryshme të vlerësimit të njohurive dhe aftësive të studentit duhet të shoqërohen edhe me komentet përkatëse për vlerësimin. Këto komente realizohen me shkrim gjatë formave të vlerësimit me shkrim si provime të ndërmjetme dhe provimi final, ose me gojë, kryesisht gjatë vlerësimit në klasë, apo për projektet e kursit, ose në rast të provimeve me gojë. Kështu psh tek rregullore e njësisë bazë, neni 25 thotë se pedagogu duhet të argumentojë vlerësimin tek studenti gjatë provimit me gojë. Kjo realizohet nga stafi akademik në këtë program studimi, duke gjykuar nga përvoja e gjatë e stafit dhe nga diskutimet gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik të programit. Referenca: 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, nenet 53 dhe 54. Vizita në institucion , takimi me pedagogët e programit të studimit.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregullorja e FB dhe Njësisë bazë departamentit të agrobiznesit paraqesin një procedurë të detajuar të organizimit dhe vlerësimit të provimeve, ku rëndësi ka dhe evitimi i situatave ku studentit i krijohet mundësia për kopjim, apo mashtrim gjatë realizimit të programit të studimit. Gjithashtu vlerësimi në përfundim të studimeve, me temë diplome, njihet si hallka ku kujdesi parësor

	është ai për plagjiaturën. Kjo patjetër është në përgjegjësi dhe detyrim të personelit akademi për secilën lëndë. <i>Referenca:</i> 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, nenet 53 dhe 54. Vizita në institucion , takimi me pedagogët e programit të studimit.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve, sipas rregullores së FB dhe rregullores së DA dhe programit të studimit bazohen në meritë për shkak se këto rezultate vijnë si rrjedhim i vendosjes së pikëve sipas rregullit. Po ashtu ka një procedurë shumë të detajuar për dhënien në kohë të rezultateve, sipas tipit të provimit. Kështu p.sh., në Rregulloren e fakultetit, por edhe në atë të gjitha mundësitë. <i>Referenca:</i> 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, nenet 53 dhe 54. Vizita në institucion , takimi me pedagogët e programit të studimit.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në rregulloren e FB në nenin 78 paraqitet dhe përacktohet e drejta e studentëve për tu njohur me rezultatin e provimit si dhe nënenin 76 e drejta për ankimim në rast të problemeve me rezultatin final, ku përcaktohet procedura për ankimim dhe detyrimet institucionale për të përmbushur kërkesat për ankimim. Po ashtu këto të drejta paraqiten edhe në rregulloren e departamentit në nenin 33 dhe 31, ku paraqitet dhe procedura që duhet të ndjekë studenti në rast të kundërshtimit të rezultatit të marrë brenda dy ditëve. <i>Referenca:</i> 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.	Pasi evidentohet ankesa me shkrim e një studenti për vlerësimin me notë për një lëndë, brenda afateve të përcaktuara të ndryshme për provimin me gojë dhe për atë me shkrim, ankimi i kalon departamentit dhe në rast të evidentimit të shkeljeve, dekani



Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	përcakton një komision tjetër për realizimin e provimit, brenda një dite nga përcaktimi i komisionit. <i>Referenca:</i> 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit; 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB			
Konkluzione	UNIKO është angazhuar përgjatë veprimtarisë së tij për të krijuar strukturat dhe procedurat e duhura për të krijuar vlerësim të drejtë dhe transparent për studentët. FB dhe DA në këtë program studimi kanë ndërtuar dhe zbatuar rregulloret përkatëse lidhur me transparencën e vlerësimit të studentëve si dhe me mundësitë për ankimim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit garanton një gjerësi njohurish duke u bazuar tek të dyja fushat ajo e bujqësisë dhe ajo e menaxhimit të turizmit. Ndërtimi i programit të studimit, syllabuset dhe rregullorja e programit të studimit, si dhe zbatueshmëria e tyre kontribuojnë në ndërtimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale. Megjithatë duhet përmendur se ka disa hapësira që mund të shfrytëzohen edhe më mire për të ngritur dhe zhvilluar njohuri të lidhura me fushën. Këto hapësira lidhen me lëndë apo njohuri të përsëritura apo mbivendosura të cilat duhen rishikuar për tu diferencuar dhe ndarë më mirë nga njëra tjetra dhe janë përmendur dhe analizuar tek standarti II.4, kriteri 1 dhe 2. <i>Referenca:</i> 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit;
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e	Programi i studimit garanton zhvillimin e disa prej aftësive në fushën humane dhe sociale të cilat i nevojiten një menaxheri të agroturizmit, duke përfshirë menaxhimin dhe marketingun si

teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	zhvillues të komunikimit dhe ndërveprimit social. Por, në fakt duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit, ky program studimi nuk ka asnjë lëndë që të lidhet me teknologjinë e informacionit, e cila është me rëndësi të vecantë kur flasim për menaxhimin dhe marketingun e turizmit, si edhe me rëndësi për zhvillimin e qëndrueshëm edhe në fermat bujqësore. Prirjet më të fundit për menaxhimin e fermave nga njëra anë dhe menaxhimin e strukturave turistike nga ana tjetër përfshijnë disa teknologjitë inovative, si Internet of Things, Marketingu digjital dhe mediat sociale, Ëeb-sitet, big data (pra bazat e mëdha të të dhënave) si dhe analizat e Ëeb-it. Prandaj edhe nuk mund të mos merret parasysh teknologjia edhe në një fushë specifike brenda turizmit sic është agroturizmi. GVJ gjykon se ka probleme dhe mungese me aftësitë e TIK, që mund të kërkojnë edhe një lëndë të vecantë. Por më tej këto aftësi nuk përmenden as brenda lëndëve të vecanta. Edhe pse departamenti mund të gjykojë se nuk ka vend për një lëndë specifike të lidhur me TIK, programi duhet të ketë patjetër tema që lidhen me TIK, në të paktën 3-4 lëndë, sic janë: Menaxhimi i destinacioneve dhe marketingu i organizatave, Turizmi i Qëndrueshëm, Menaxhimi i burimeve natyrore, Dizenjimi i produkteve turistike, etj. Ndërsa sa i përket aftësive të gjuhës së huaj ato nuk gjenden fare në programin e studimit. <i>Referenca:</i> <i>2.7 Plani mësimor I programit të studimit</i> <i>2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Shqyrtimi dhe analiza e aftësive dhe kompetencave që fiton studenti realizohet nëpërmjet testeve në klasë, diskutimeve të rasteve apo detyrave dhe projekteve të dhëna, duke zbatuar tematikat në syllabuset e lëndës. Nëpërmjet metodave të mësimdhënies stafi akademik nënvizon çështjet më të rëndësishme dhe orineton në zbatimin e tyre. Gjithashtu studentët orientoohen nga departamenti dhe stafi përgjegjës i përcaktuar për detyrimet përmbyllëse sic janë praktika dhe diploma, në mënyrë që të zbatohet rregullorja e FB, Rregullorja e deëpartamentit dhe rregullorja e programit të studimit. Analiza e punës në departament tregon për arritjet edhe në funksion të procesit mësimor dhe praktikën e studentëve.

	Referenca: 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njesisë bazë.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Kompetencat e synuara për tu ndërtuar tek studentët pasqyrohen në syllabuset e lëndëve. Ato përmbajnë mjaftueshëm njohuri teorike për lëndët përkatëse, por përmbajnë më pak ose në disa raste nuk përmbajnë elemente të njohurive praktike apo rasteve studimore të përdorura. Nga vizita në institucion dhe takimi me pedagogët e programit të studimit si dhe nga takimi me studentët evidentohet se përdoren rastet studimore, puna në grup me projekte apo detyra. Megjithatë ka pak evidenca të krijimit të një klime inovacioni edhe për shkak të mundësive të kufizuara të bizneseve në fushën e agroturizmit si dhe për shkak të orientimit profesional dhe jo atij shkencor të masterit në fjalë. Sa u përket institucioneve bashkëpunuese, ato janë prezent në programin e studimit në formën e mbështetësve për praktikat e studentëve, por GVJ sygjeron që mund të zgjerohet bashkëpunimi në funksion të metodave më inovative në mësimdhënie si lektorë të ftuar nga industria apo vizita në bizneset përkatëse, diskutime për zgjidhje konkrete në bizneset agroturistike etj. Theksojmë se ky program studimi mund të përfitojë edhe më tepër në këtë drejtim. Referenca: 2.8 Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset) Vizita në institucion takimi me stafin e programit Vizita në institucion takimi me studentët e programit 3.6 Raporti i përfitimit nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë	Personeli akademik efektiv realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillimet më të fundit. Ka disa evidenca të orëve të hapura të zhvilluara në UNIKO dhe specifiku nga Fakulteti i Bujqësisë, por ajo që vihet re është se nuk ka të tilla specifike pikërisht për këtë program studimi.

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Referenca: 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë; 3.10 Praktika e Organizimit të Tryezave të Përbashkëta me përfaqësues të Sektorit Publik/Privat;			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UNIKO nxit zhvillimin e ideve inovative, duke përfshirë edhe studentët në tryezat e rrumbullakëta apo në diskutimet lidhur me agroturizmin. Temat e diplomës të realizuara në këtë program kanë një nivel të mirë të kërkimit shkencor. Por në aspekte më të avancuara në këtë program nuk aplikohet në thellësi kërkesa për punë kërkimore dhe inovacion, duke qenë se edhe niveli i masterit është profesional. Referenca: 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë; 3.10 Praktika e Organizimit të Tryezave të Përbashkëta me përfaqësues të Sektorit Publik/Privat;			
Konkluzione	Programi i studimit përpjeket të ndërtojë kompetenca dhe njohuri të zgjeruara tek studentët në fushën e agroturizmit. Në grupin e aftësive, ato krijuese e zbatuese janë të identifikuar për secilën lëndë dhe ka përpjekje të mira për t'i ndërtuar këto kapacitete përmes metodave praktike si rastet studimore, detyra e projekte, praktika dhe bashkëpunim me aktorët me të cilët institucioni ka marrëveshje. Megjithatë, sa i përket disa aftësive praktike dhe njohurive që aktualisht jep programi, ka vend për përmirësim, pasi duhen reduktuar ato lëndë që kanë mbivendosje duke u dhënë më shumë vend aftësive që aktualisht mungojnë si psh aftësitë e lidhura me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Detyrimet përmbyllëse të programit përfshijë praktikën dhe diplomën. Diplomimi realizohet sipas rregullores së programit me provim (formimi) të përgjithshëm përfundimtar, ose me punim diplome, kur plotëson kriterin e notës mesatare të vendosur nga njësia bazë.

	Nëse realizohet me provim formimi, teza e provimit është gjithëpërfshirëse, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Sa i përket përcaktimit të studentëve që do realizojnë përmbylljen e studimeve me temë diplome, evidentohen ata që plotësojnë kriterin e notës mesatare dhe më pas ata kanë të drejtë të dorëzojnë një kërkesë në lidhje me temën dhe udhëheqësin e diplomës . <i>Referenca:</i> 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	DA nëpërmjet rregullores së diplomimit përcakton standartet dhe kriteret e punimit të diplomës dhe me vendim përcakton listën e temave për diploma në fillim të semestrit të dytë për ciklin e dytë të studimeve. Lista e studentëve të miratuar për temë dhe udhëheqësit I kalojnë për miratim Dekanit të FB në fillim të semestrit të dytë. Gjithashtu, në fund të semestrit të parë të vitit parë, departamenti përcakton fushat dhe temat e studimit, emrat e studentëve, prapun e notës mesatare të studentëve fitues dhe parametrat e mikrotezës. <i>Referenca:</i> 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB 2.22 Vendim Departamenti “Mbi miratimin e fushave të kërkimit dhe temave të diplomës 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në rastin e realizimit të detyrimeve përmbyllëse me provim, ai realizohet përpara një komisioni të posaçëm. Komisioni miratohet nga decani me propozim të Përgjegjës të departamentit, dhe përbëhet nga pedagogë të departamentit (dhe të departamenteve të tjera në këtë program), sipas fushave që mbulon programi i provimit. Kryetari i komisionit përgjithësisht është Përgjegjësi i Departamentit. Provimi gjithashtu është gjithëpërfshirës pasi teza e provimit përmban pyetje nga fushat që përfshihen në programin e provimit. Ajo hartohet bazuar mbi një fond pyetjesh të parashpallur dhe të komunikuar me studentët, me përzgjedhje nga secili prej anëtarëve të komisionit. Provimi organizohet me gojë dhe rezultatet u jepen studentëve në fund të ditës së provimit.

	<i>Referenca:</i> <i>2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB</i> <i>2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Kur provimi realizohet me punim diplome, një hallkë shumë e rëndësishme është udhëheqësi i punimit të diplomës. Është I që përgatit programin e punës së studentit, duke përcaktuar edhe kohën e zhvillimit të pikave të ndryshme të realizimit të projektit. Mbrojtja me sukses e temës nga studenti kërkon dhe respektimin e afateve të vendosura Gjatë periudhës së realizimit të punimit, rregullorja parashikon edhe zhvillimin e konsultimeve të programuara me për diskutime dhe kontroll të punës. Punimi firmoset dhe miratohet për të kaluar në komision. Rregullorja njeh gjithashtu oponentin e temës së diplomës që është një pedagogi caktuar nga përgjegjësi i departamentit. <i>Referenca:</i> <i>2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB</i> <i>2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nën strukturën e vet FB, administron edhe Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE), që shërben si një laborator fushor (natyral), krahas infrastrukturës laboratorike didaktike. Nëpërmjet këtyre strukturave ndihmës-akademike pedagogë dhe studentë të programit mund të realizojnë veprimtarisë akademike, studime apo projekte të ndryshme studimore. Në këtë program studimi studentët nuk kanë realizuar konkretisht studime, por praktika mësimore profesionale si dhe aktivitetet e ndryshme. EDE nëpërmjet personelit mbështet dhe mund të konsultojë për metodologjitë e përpunimit të të dhënave. <i>Referenca:</i> <i>1.8 Rregullore e Drejtorisë Financiare (EDE)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Detyrimi përmbyllës i diplomës, qostë me provim përfundimtar të përgjithshëm, qoftë me mbrojtje të temës së diplomës realizohet përpara një komisioni të ngritur për këtë qëllim, i cili vlerëson punën/përgjigjen e studentit me notë, sipas kritereve të vlerësimit dhe rregulloreve eligjeve në fuqi. Notat minimale kaluese është 5

	dhe nota maksimale është 10. Vlersimi me notë vjen si rrjedhim i dakortësisë apo notës mesatare të komisionit. <i>Referenca:</i> 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët pajisen me diplomë pasi kanë përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit (MP). Diploma është dokument zyrtar dhe shoqërohet gjithashtu nga modeli i diplomës nga Universiteti Bujqësor i Plovdiv dhe UNIKO. 270. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar 271, 272. Emërtimi i diplomave (MP) të FB, bëhet në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studenti. 273 Suplementi i diplomës është hartuar sipas kërkesave të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë, dhe përshkruan natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Suplementi i diplomës në formë dhe përmbajtje përcaktohet përcaktohen në statutin e UNIKO në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. <i>Referenca:</i> 2.6 Modeli i diplomës & suplementi i programit të studimit "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm"
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Pas përfundimit të studimeve institucioni përgatit certifikatat e diplomimit, të cilat regjistrohen në regjistrin shtetëror të certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. UNIKO, duke qenë se ruan kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. <i>Referenca:</i> 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Neni 70, pika 6 dhe 7;
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Ato përfshijnë përmbylljen</i>

	me provim të përgjithshëm ose me temë diplome, ku në secilin rast departamenti përmes koordinatorit të programit dhe përfaqësuesve të vet, ofron gjithë dokumentacionin e nevojshëm zyrtar që studentët të kenë mundësi për të punuar dhe për të përfunduar studimet në një mjedis të ekuilibruar dhe transparent në lidhje me gjithë procesin.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	FB, administron një numër të konsiderueshëm laboratorësh (10 të tillë) të përbërë nga pajisje bashkëkohore, si dhe qendrën didaktike Ekonomia Didaktike Eksperimentale (EDE). Ato përdoren në funksion të veprimtarisë akademike, të aktiviteteve kërkimore shkencore por sidomos në funksion të aftësimit teorik e praktik të studentëve. Infrastruktura laboratorike mbështet zhvillimin e orëve të laboratorit, por që në këtë program studimi nuk janë ose janë shumë pak prezente. EDE është një njësi kërkimore në terren me sipërfaqe 16.5 ha, nëpërmjet së cilës studentët mund të realizojnë aktivitete proaktike, kryejnë krahasime nëpërmjet testeve etj. <i>Referenca:</i> 4 Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit (Tabela 16); 1.8 Rregullore e Drejtorisë Financiare (EDE) 3.20 Infrastruktura e përfituar nga projektet
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të	UNIKO, dhe në kontekstin e programit të studimit FB dhe DA kane partneritete e duhura me ente publike dhe kompani private si dhe agjenci shtetërore apo organizma të pushtetit lokal për të ndërtuar një program praktike apo stazhi të studentëve të programit, me qëllim marrjen dhe zbatimin e aftësive dhe njohurive praktike, duke cuar drejt një stafi me kompetencë profesionale në të nesërmen.

njohurive dhe kompetencave profesionale.	Referenca: 2.10 <i>Marreveshje bashkepunimi per praktikat profesionale</i>			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktikat profesionale në programin MP MQA realizohen nga studentët duke zbatuar udhëzimet përkatëse dhe mbështetjen institucionale nëpërmjet zbatimit edhe të procedurave të mirëpërcaktuara për praktikën në rregulloret e FB, DA dhe programit. Praktika drejtohet nga stafi akademik i caktuar për monitorimin e saj dhe zhvillohen në institucione/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit. Dokumentacioni i praktikës përfshin programin sipas lëndëve të programuara për këtë nga departamenti si dhe relacionin. E dorëzuar nga studenti për punën e kryer . Pas dorëzimit të dokumentacionit të praktikës nga studenti dhe firmosjes nga mentori pedagog , realizohet mbrojtja e praktikës nga komisioni i ngritur në departament. Dokumentacioni përmban edhe vlerësimin e kompanisë ku është kryer praktika. Vlerësimi final i praktikës profesionale bëhet me notë. Referenca: 2.2 <i>Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB</i> 2.3 <i>Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit</i>			
Konkluzione	Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës profesionale, ku marrëveshjet në këtë drejtim me institucionet ndikojnë pozitivisht në realizimin e praktikës. Gjithashtu dokumentacioni për këtë është i plotë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Plani mësimor i programit të studimit, CV të stafit të angazhuar në këtë program, procedura rekrutimi stafi akademik apo edhe RVB, konstatohet se stafi PAE dhe PAK janë me kualifikimet, edukimin, dhe hulumtime që janë të lidhura me fushën që mbulon programin e studimit.

Konstatohet se kryesisht edukimi dhe kualifikimet janë në fushën e menaxhimit, marketing, ndërsa hulumtimet apo edhe angazhimet në projekte janë në fushën e turizmit, dhe më konkretisht atë të agroturizmit.

Viti Akademik	PAE	PAK
2023-2024	11 (1 Prof.Dr; 6 Porf.Asoc.; dhe 3 Dr.)	
2024-2025	10 (1 Prof.Dr; 5 Porf.Asoc.; dhe 4 Dr.)	1 (Prof. Dr)

Reference;

2.9 Jeteshkrimet e stafit akademik.pdf

2.17 Listë e botimeve të stafit akademik.pdf

2.17.1 Botime në kuadër projektesh.pdf

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht RVB, Plani mësimor për vitin 2023-2024 rezulton se orët e realizuara nga staf PAE (nga dy IAL-të ofruese të programit) arrin në 100%. Ndërsa bazuar në Planin mësimor për vitin 2024-2025, rezulton se orët e realizuara nga staf PAE arrin në 89.8%.

Reference;:

2.7 plani mesimor i programit te studimit

	<i>4_te dhena statistikore per stafin, studentet & programin e studimit</i> <i>2.8_programet lendore te programit te studimit (syllabuset).pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Mbështetur në dokumentet me të dhëna statistikore për stafin, rregullore e drejtorisë financiare, planin mësimor në dy vitet e fundit, dhe intervistave në ambientet e IAL-së gjatë vizitës, rezulton se kjo njësi bazë, ka një qëndrueshmëri në stafin e angazhuar PAE. Për më tepër, gjatë një periudhë kohore prej më shumë se 5 (pesë) vitesh, qëndrueshmëria e stafit akademik efektiv është e dukshme duke pasur një nivel afër 0 të qarkullimit të stafit. Vetëm vitin e fundit është rekrutuar një staf PAK, duke respektuar standardet dhe procedurat në fuqi dhe në përputhje me kuadrin ligjor. <i>Reference;</i> + <i>Shtojca 1.8 RREGULLORE E DREJTORISË FINANCIARE (EDE).PDF</i> <i>4 TE DHENA STATISTIKORE PER STAFIN, STUDENTET & PROGRAMIN E STUDIMIT.pdf</i> <i>2.7_PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i Statuti, konkretisht Neni 45, si edhe si edhe të udhëzimit për rekrutimin e stafit akademik krijohet bindja se garantohej përzgjedhja e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kështu, kriteri i specialitetit të diplomës dhe nota mesatare (8 e lart) janë kritereve me avantazhim dhe ne rast të mungesës së tyre, shndërrohen edhe skualifikuese për çdo kandidat. <i>Reference;</i> <i>Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Neni 45</i> <i>Shtojca 1.13 udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore,	Në nenin 4 të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, përcaktohen qartë ndarja në personel ndihmës–akademik me karakter mësimor (laborantët), dhe personel ndihmës akademik me karakter administrative. Mbështetur në struktura & organigrame e UNIKO, viti akademik 2024-2025, fq. 5, rezulton se DA, ku bën pjesë dhe program në fjalë, ka një 1 (një) punonjës të angazhuar si personel ndihmës akademik (i kategorizuar si laborant/sekretar). Ky staf ndihmon në

sipas natyrës specifike të programit të studimit.	realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. <i>Reference;</i> 2.2_RREGULLORE E ORG TË VEPRIMTARISE MËSIMORE E SHKENCORE E FB.pdf 2.15_Struktura & organigrame e uniko, viti akademik 2024-2025.pdf
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Mbështetur në Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, neni 8, përcaktohet qartë se Sektori i Burimeve njerëzore dhe protokolli mban të dhëna rreth stafit akademik dhe ndihmës-akademik (si dosja personale e stafit, librezat etj.). Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, pranë Rektoratit administron dhe përditëson të gjithë dokumentacionin e personelit akademik të Departamentit të Agrobiznesit. Po ashtu, mbështetur në nenin 11, dhe 17, të rregullores së njësisë bazë, rol në këtë proces ka edhe sekretaria e saj e cila disponon të dhënat e nevojshme të procesit mësimor në kuadër të cilit zhvillohet ky program studimi. <i>Reference;:</i> Shtojca 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit Shtojca 1.4 RREGULLORJA E DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE.pdf
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Në këndvështrimin procedural, IAL-ja zotëron rregullore dhe procedura të mjaftueshme që rregullojnë realizimin e praktika mësimore dhe profesionale. Në vijim, nga shqyrtimi i dokumentacionit, kryesisht të marrëveshjeve me aktorë të tregut (publik dhe privatë), krijohet garanci për mbështetje nga ana e institucionit për studentët në realizimin e praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Po ashtu, ky IAL, nëpërmjet rregullores së praktikave profesionale, në neni 21, parashikon monitorimin e praktikës profesionale në vendin e punës nga ana e stafit akademik që njihet edhe si supervizor. Supervizori ka rol në instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në këtë drejtim. <i>Reference;</i>

	2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 46; 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale; 2.10.1 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale; 3.21 _udhezues & rregullore e praktikave profesionale.pdf			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, ky aspekt garantohet nëpërmjet udhëzuesit dhe rregullores së praktikave profesionale. <i>Reference;</i> 3.21 _udhezues & rregullore e praktikave profesionale.pdf			
Konkluzione	Stafi akademik dhe ndihmës në programin "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" në UNIKO përmbush standardet e kualifikimit dhe angazhimit në fusha të lidhura me agroturizmin. Qëndrueshmëria e stafit PAE është një pikë e fortë, me qarkullim të ulët ndër vite, ndërsa rekrutimet e reja respektojnë kriteret ligjore dhe rregulloret. Procedurat dhe marrëveshjet me aktorë privatë dhe publikë garantojnë mbështetje për praktikat profesionale dhe mbrojtjen e diplomës, të monitoruara nga supervisorë. Përmirësimi i këtij aspekti varet nga zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës dhe pajisjeve praktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në	Nga analiza e dokumentacionit dhe mbi të gjitha nga vizita në ambientet e IAL-së, rezulton se Godina e Fakultetit të Bujqësisë (FB) brenda kampusit universitar të UNIKO është ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore, duke ofruar kushte optimale për mësim

varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	dhe veprimtari shkencore. Ajo ka një sipërfaqe prej 3006 m² dhe përfshin 4 auditore, 12 klasa, 9 laboratore, një bibliotekë, si dhe salla për seminare e konferenca të pajisura me mjete teknologjike moderne, si video projektorë dhe tabela interaktive. Gjithashtu, ndërtesa është e pajisur me sistem ngrohjeje qendrore, izolim akustik dhe termik, si dhe me ndriçim natyral që plotëson normat teknike. Sensorët termikë, pajisjet kundër zjarrit dhe tabelat treguese për emergjenca kontribuojnë në sigurinë e mjediseve. Fakulteti disponon një qendër kërkimore eksperimentale, Ekonomia Didaktike Eksperimentale (EDE), me një sipërfaqe prej 16.5 hektarë, që shërben për punë praktike dhe projekte kërkimore për studentët dhe stafin akademik. Po ashtu, UNIKO ofron një bibliotekë të pasur dhe librarinë online “U-LIBRARY,” për të mbështetur kërkimet dhe studimet. Infrastruktura e FB dhe UNIKO ndihmon aktivitetet akademike dhe shkencore, duke siguruar mjedise moderne, teknologji të avancuar dhe mbështetje për programe studimore dhe kërkimore. Theksojmë se Programi i ciklit të dytë të studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” zhvillohet kryesisht në godinën e FB, i cili është organizuar dhe funksionon në brendësi të kampusit të UNIKO. <i>Reference;:</i> <i>1.15 Raport i kontrollit të MAS për kapacitetet pritëse të UNIKO 2023-2024</i> <i>4. Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit;</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Të gjitha ambientet e Fakultetit të Bujqësisë (FB), ku zhvillohet edhe procesi mësimor nga ana e studentëve të MP “Menaxhim i qëndrueshëm në agroturizëm”, janë të pajisura me internet (kabllor dhe ëireless), video projektorë dhe pajisje kompjuterike. Sallat e konferencave mbështesin aktivitete ndërkombëtare me sisteme video-konferencash dhe klasa hibride. Investimet në pajisje teknologjike janë realizuar nga UNIKO dhe projekte ndërkombëtare, duke përmirësuar procesin mësimor me laptopë dhe projektorë portativë për pedagogët. Kjo infrastrukturë garanton metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe akses të plotë për studentët. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne IAL, dhe intervista me stafin</i>

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Fakulteti i Bujqësisë (FB) ofron 10 laboratore didaktike dhe laboratorin fushor EDE, të pajisura me teknologji bashkëkohore për aftësimin teorik e praktik të studentëve. Laboratorët mbulojnë fusha si analiza e tokës, prodhimi gjenetik i bimëve, mikrobiologjia dhe proceset kimike. Studentët shfrytëzojnë gjithashtu laboratorët e fakulteteve të tjera për module specifike (informatike etj.). FB ka një sallë video-konferencash, klasë hibride dhe qendër për transferimin e teknologjive, në shërbim të programeve të studimit, dhe më konkretisht të studentëve të këtij program studimi. Të gjitha ambientet didaktike janë të pajisura me IT për të përmbushur kërkesat e kurrikulës mësimore. <i>Reference;:</i> <i>Vizita ne IAL, dhe intervista me stafin</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Programi i ciklit të dytë "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" shfrytëzon laboratorin e transferimit të teknologjive, laboratorin e informatikës, laboratorin fushor (EDE), dhe klasën hibride për seminare. Janë krijuar laboratorë për mësim online, takime dhe trajnime, në mbështetje të stafit dhe studentëve. <i>Reference;:</i> <i>Vizita ne IAL, dhe intervista me stafin</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, më konkretisht, i marrëveshjeve të nënshkruara me aktorë të sektorit privat dhe publik, studentët e kanë mundësinë e realizimit të praktikave mësimore dhe ato profesionale. <i>Megjithatë, bazuar fushës specifike dhe shumë praktike të këtij program studimi, një vlerë e shtuar në cilësinë e realizimit të praktikave mësimore dhe ato profesionale do të ishte zotërimi nga vetë IAL-ja, të infrastrukturës qoftë dhe maket për praktika në njësi akomodimi, shërbimi etj., që janë karakteristika të veprimtarive të njëjseve agroturistike.</i> Për shembull, maket shërbimi për akomodimin, shërbim ushqimi dhe pije (restorant), lavanderi, ferma didaktike etj. Këto aspekte të infrastrukturës së realizimit të praktikave mësimore dhe profesionale, mungojnë. <i>Reference;:</i> <i>Këqyrja gjatë vizitës në ambientet e IAL</i> <i>2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale</i> <i>2.10.1 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale</i>

Konkluzione	Fakulteti i Bujqësisë i UNIKO-s ofron një infrastrukturë të ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore, me hapësira të pajisura për mësim, kërkime shkencore dhe veprimtari ndërkombëtare. Ajo përfshin auditore, klasa, laboratorë dhe qendrën fushore EDE, të gjitha të pajisura me teknologji moderne dhe internet. Megjithatë, për programin "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm," ndihën mungesat e maketeve specifike për praktika profesionale, si njësi shërbimi apo ferma didaktike, që do të mundësonin një përvojë më të plotë praktike për studentët në këtë fushë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacioneve, rezulton se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (shqip dhe Anglisht) është e mjaftueshme. nga shqyrtimi i programeve lëndore të programit të studimit (syllabuset), konstatohet se çdo lende ka literature baze dhe te kombinuar me literature te rekomanduar. <i>Referencë:</i> <i>2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT (SYLLABUSET).pdf</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	UNIKO disponon katër biblioteka pranë fakulteteve, që përfshijnë libra, revista, enciklopedi, harta, albume dhe fjalorë. Fondi përbëhet nga 17,205 tituj (44,042 kopje) në shqip dhe gjuhë të huaja, kryesisht anglisht dhe frëngjisht. Me kartela personale janë regjistruar 1,444 studentë dhe 270 pedagogë. Hapësira e studimit prej 562 m ² dhe pajisjet kompjuterike janë në dispozicion të studentëve, me orar 08:00-16:00 gjatë javës. Me 14 milionë lekë të siguruar nga AKKSHI, fondi i bibliotekës është dixhitalizuar, duke përfshirë Fondin Nolian. Nëpërmjet bibliotekave ose burimeve online të rekomanduara nga pedagogët, studentët mund të tërheqin materiale. Biblioteka shkencore ofron akses në platformën JSTOR (https://ëëë.jstor.org) si një burim digjital për literature shtese.

	Punonjësit e bibliotekave Shkencore të UNIKO dhe FB përditësojnë literaturën për t'u informuar stafin akademik, ndihmës-akademik dhe studentët për botimet e fundit, përmes emailit zyrtar ose bibliotekave fizike dhe virtuale. <i>Reference;</i> 2.17 Lista e botimeve të stafit akademik; 3.17 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave;
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Materialet e programeve të studimit ofrohen si tekste, dispensa dhe literaturë nga autorë vendas e të huaj. Ato gjenden në bibliotekat e UNIKO dhe FB, përfshirë burime online si EIFL. Studentët marrin materiale shitesë nga lektorët, përmes Microsoft Teams ose adresave të sugjeruara online. Katër bibliotekat e UNIKO përmbajnë 17,205 tituj (44,042 kopje) në disa gjuhë dhe ofrojnë hapësirë studimi prej 562 m² me pajisje kompjuterike. Me fonde nga AKKSHI dhe buxheti vjetor, është mbështetur dixhitalizimi dhe pasurimi i bibliotekave. <i>Reference;</i> Vizita ne ambientet e IAL 3.17 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave;
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bibliotekat e UNIKO dhe FB përmbajnë libra, revista, enciklopedi, gazeta, albume dhe fjalorë për fusha specifike. Fondi total përfshin 17,205 tituj (44,042 kopje) në gjuhën shqipe dhe të huaja, kryesisht anglisht dhe frëngjisht. Bibliotekat ofrojnë një hapësirë studimi prej 562 m² dhe pajisje kompjuterike për studentët. Buxheti institucional garanton fonde vjetore për pasurimin e bibliotekave me literaturë të kërkuar nga personeli akademik. Këto burime ndihmojnë studentët në hulumtimet për detyrat e kursit, projektet lëndore dhe punimet e diplomës. Thuajse për çdo lëndë, literatura bazë e rekomanduar mund të gjendet pranë bibliotekës së FB. <i>Reference;</i> Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin 3.17 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave;
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	IAL-ja, nëpërmjet bibliotekës ofron literaturë nga autorë vendas dhe të huaj, e disponueshme në dhe bibliotekën e FB. Bibliotekat ofrojnë gjithashtu informacione online nga burime elektronike, duke përfshirë aksesin në EIFL (Electronic Information for Library). Si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare,

bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka Shkencore e UNIKO siguron burime elektronike falas për studentët. Përveç punës në biblioteka, ofrohet edhe komunikim virtual për t'i afruar studentët më pranë burimeve të saj dhe librit. <i>Referenca:</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>3.17 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekave;</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Bibliotekat shkencore të UNIKO dhe FB ofrojnë ambiente studimi të pajisura me kompjutera, internet dhe video-projektorë, duke u mundësuar studentëve të punojnë individualisht ose në grup. Kompjuterët përmbajnë programe bazë që shërbejnë për realizimin e detyrave sipas moduleve. Numri i madh i posteve të punës dhe aksesueshmëria e pajisjeve teknologjike sigurojnë përdorimin e lirë nga të gjithë studentët. <i>Referenca:</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë bibliotekat nga ora 08:00 deri në 16:00, gjatë ditëve të javës. Aktualisht, biblioteka përdoret nga 1,444 studentë dhe 270 pedagogë që disponojnë kartela personale. Fondi total përmban 17,205 tituj (44,042 kopje) në shqip dhe gjuhë të huaja, kryesisht anglisht dhe frëngjisht. Bibliotekat ofrojnë hapësirë studimi prej 562 m² dhe pajisje kompjuterike të aksesueshme për studentët. <i>Referenca:</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin e Bibliotekës</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah	Stafi i bibliotekave është përgjegjës për përditësimin e fondit fizik dhe atij online, duke monitoruar cilësinë dhe shkallën e përdorimit nga studentët dhe personeli akademik. Bibliotekat e UNIKO shërbejnë rreth 1,450 studentëve, 270 pedagogëve dhe përdoruesve të jashtëm nga fusha të ndryshme studimore. Frekuentimi evidentohet periodikisht, duke përfshirë ndarjen sipas kategorive. Me fonde vjetore, bibliotekat pasurohen me literaturë të kërkuar nga personeli akademik. Gjithashtu, UNIKO ka siguruar një fond prej 14,000,000 ALL nga AKKSHI për dixhitalizimin e bibliotekës shkencore, përfshirë Fondin Nolian. <i>Referenca:</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin e Bibliotekës</i>

sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	UNIKO ofron literaturë të mjaftueshme për studentët, të kombinuar midis burimeve bazë dhe ndihmëse në shqip dhe gjuhë të huaja si anglisht dhe frëngjisht. Katër bibliotekat e universitetit përmbajnë 17,205 tituj (44,042 kopje), hapësira studimi prej 562 m² dhe pajisje kompjuterike. Me mbështetje nga AKKSHI, fondet dixhitale janë pasuruar, përfshirë Fondin Nolian dhe platforma si JSTOR. Komunikimi për burime dhe përditësime realizohet përmes bibliotekave fizike, platformave virtuale si EIFL, dhe e-mailit. Literatura ndihmon studentët për kërkimet akademike, ndërsa frekuentimi dhe përdorimi monitorohen rregullisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UNIKO është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), duke përdorur një sistem dixhital të integruar për administrimin efikas të të dhënave dhe sigurimin e shërbimeve më të mira për studentët dhe stafin akademik. Aktualisht përdor sistemin "PITAGORA" dhe faqja zyrtare e universitetit, ëëë.unkorce.edu.al, pasqyron informacione të vlefshme dhe përditësime të vazhdueshme. Përmes platformës Office 365 dhe pajisjeve elektronike në kampus, studentët dhe stafi komunikojnë në mënyrë të lehtë dhe efektive. Gjithashtu, tre regjistra zyrtarë dhe arkivi elektronik sigurojnë ruajtjen dhe menaxhimin e dokumentacionit. <i>Reference;</i> 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK 1.6.1 Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA; https://unk.pitagora.rash.al/ http://unkorce.edu.al/kendi-i-maturanteve/

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Informacioni dhe dokumentacioni i stafit të angazhuar menaxhohet sipas natyrës dhe strukturohet në departamente, fakultete, rektorat, drejtorinë juridike e të burimeve njerëzore, dhe atë të financës. Departamenti merret me veprimtarinë akademike e shkencore dhe informacioni përcillet në analizat vjetore. Dokumentacioni përfshin planet mësimore, rregulloret dhe formularët e ngarkesave mësimore. Drejtoria Juridike arkivon të dhëna për punësimet dhe kualifikimet e stafit, ndërsa Drejtoria e Financës përditëson informacion mbi pagat dhe shpërblimet. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në dokumente për personelin dhe studentët. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>1.4 Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar për personelin akademik, ndihmës dhe studentët përmes një administrimi të organizuar të dhënave. Ëëbsitet personale të pedagogëve, seksionet e dedikuara në Ëëbsite-in e UNIKO, dhe platforma Office 365 lehtësojnë ndarjen e informacionit për modulet dhe materialet përkatëse. Gjithashtu, stendat informuese dhe trajnimet e organizuara nga sektori i TIK ndihmojnë në orientimin dhe shfrytëzimin e informacionit. Ky sistem i integruar garanton qasje transparente dhe të përshtatshme për të gjitha palët. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin;</i> <i>2.15 Struktura dhe Organigrama e UNIKO (Viti Akademik 2024-2025);</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Në rastin e UNIKO, sistemi i menaxhimit integron platformën dixhitale “PITAGORA,” e cila mundëson komunikim interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Përmes kësaj platforme, studentët marrin informacion në kohë mbi aktivitetet akademike, oraret, rezultatet dhe dokumentet e tjera të rëndësishme. Gjithashtu, përdorimi i platformës Office 365 me adresat elektronike @unkorce.edu.al dhe monitorët informues në fakultete e forcojnë këtë komunikim. Këto module integrohen për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit dhe efikasitetin në administrim. <i>Reference;:</i>

	<i>vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.6.1 manual i sistemit elektronik pitagora.pdf</i> <i>Shtojca 1.6 marrëveshja me rash për sistemin elektronik pitagora.pdf</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në rastin e UNIKO, sistemi i menaxhimit, përmes platformës dixhitale "PITAGORA," garanton monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative. Ky sistem mundëson evidentimin dhe raportimin e të dhënave individuale dhe kolektive në kohë reale, duke u ofruar organeve dhe autoriteteve drejtuese, si dekanatet apo sekretariatë, informacion të azhurnuar për të ndjekur dhe analizuar ecurinë e procesit mësimor dhe administrativ. <i>Reference;:</i> <i>vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> https://unk.pitagora.rash.al/			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në rastin e UNIKO, informacionet mbi programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme publikohen në faqen zyrtare të internetit në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Kjo siguron qasje të gjerë dhe informim efektiv për studentët dhe publikun e interesuar. <i>Reference;:</i> <i>vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> www.unkorce.edu.al/archive/programet_studimet/FB/index.php			
Konkluzione	<i>UNIKO ka integruar një sistem dixhital të avancuar për administrimin e të dhënave, si platforma "PITAGORA," që përmirëson komunikimin dhe efikasitetin akademik. Studentët dhe stafi kanë akses të lehtë në informacion mbi oraret, rezultatet dhe dokumentet përmes adresave @unkorce.edu.al dhe platformës Office 365. Stenda informuese dhe trajnime të organizuara nga sektori TIK sigurojnë orientim të qartë për përdorimin e sistemeve. Publikimet e informacionit në shqip dhe anglisht përmes faqes zyrtare dhe moduleve të dedikuara garantojnë transparencë dhe akses për të gjitha palët..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton një raport financiar të kostove për njësitë bazë përgjegjëse për programet e studimit, përfshirë dhe njësisë Drejtim Agrobiznesi”. Ky raport përfshin analizën e nevojave financiare për realizimin e aktiviteteve akademike dhe kërkimore. Më tej, plani financiar, i hartuar nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës, reflekton nivelin e mbështetjes për mbarëvajtjen e programeve për një cikël të plotë studimi. Raporti dhe plani miratohen nga organet drejtuese, duke siguruar transparencë dhe përputhje me objektivat institucionale. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave e UNIKO, Neni 4;</i> <i>Shtojca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave e UNIKO, Neni 6;</i> <i>Shtojca 1.7 Rregullore e Drejtorisë Ekonomike;</i> <i>Shtojca 1.8 Rregullore e Drejtorisë së Financës;</i> <i>Shtojca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave e UNIKO;</i> <i>Shtojca 3.15 Praktika e miratimit të buxhetit UNIKO</i>

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të	Në rastin e UNIKO, plani i financimit të njësisë bazë për programin e studimit përfshin: financimin e burimeve njerëzore për realizimin e programeve, mbulimin e shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, si dhe investimet për bibliotekën, pasurimin e literaturës dhe aksesin në bibliotekat online. Ai përfshin gjithashtu detyrimet financiare, grantet vendase dhe ndërkombëtare, kontratat e shërbimeve të lidhura me funksionimin e programeve të studimit, projektet përkatëse dhe elementë të tjerë mbështetës të nevojshëm për mbarëvajtjen e aktiviteteve akademike dhe kërkimore. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave e UNIKO, Neni 4;</i> <i>Shtojca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave e UNIKO, Neni 6;</i> <i>Shtojca 1.7 Rregullore e Drejtorisë Ekonomike</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni kryen auditime periodike përmes strukturave të kontrollit të brendshëm dhe auditimeve të jashtme nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të MAS dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Rezultatet e këtyre auditimeve raportohen në analiza vjetore me pjesëmarrjen e gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve, si dhe publikohen në Programin e Transparencës. Ky proces vlerëson gjendjen e financimit, efektivitetin financiar dhe propozon masa për përmirësim, duke siguruar transparencë dhe përgjegjësi në menaxhimin financiar. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> ee.unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2 <i>Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;</i> <i>Shtojca 1.11 Rregullore e Senatit Akademik;</i> <i>Shtojca 1.19 Rregullore e Bordit të Administrimit</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni raporton në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Ky raportim përfshin analiza financiare që reflektojnë përdorimin e burimeve dhe efektivitetin e tyre në arritjen e objektivave akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, duke

	konsideruar transparencë dhe llogaridhënie për autoritetet drejtuese dhe palët e interesuara. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> www.unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2 <i>Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i raporti i analizës vjetore të UNIKO (faqe 84-95), mund të bëhet një analizë për aspektin financiar të IAL, por jo mbi njësinë bazë. Mbi bazë të informacionit të marrë nga intervista me stafin respektin në IAL, arsyetohet se institucioni siguron qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin dhe ecurinë normale të programeve të studimit të njësisë bazë, duke alokuar fonde në përputhje me nevojat e tyre. Në rastet kur identifikohen nevojat për përmirësim të situatës financiare, UNIKO harton ndërhyrje të posaçme dhe eksploron mundësi për diversifikimin e burimeve financiare, duke përfshirë fonde nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunime me palë të treta, si dhe rritjen e të ardhurave nga shërbime të ofruara. Kjo qasje siguron mbështetje të qëndrueshme dhe zhvillim të vazhdueshëm të programeve të studimit. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>2.4 Raporti i analizës vjetore e uniko.pdf</i>			
Konkluzione	UNIKO harton dhe zbaton raporte financiare të detajuara që adresojnë nevojat financiare të njësisë bazë për aktivitetet akademike dhe kërkimore. Plani financiar, i miratuar nga organet drejtuese, mbështet burimet njerëzore, shpenzimet operacionale dhe investimet infrastrukturore. Auditimet periodike garantojnë transparencë dhe përgjegjësi financiare. Raportimet vjetore analizojnë efektivitetin e përdorimit të burimeve në arritjen e objektivave akademike dhe kërkimore, ndërsa publikimi i rezultateve në Programin e Transparencës përforcon besimin dhe angazhimin institucional. Sfida mbetet zbatimi efektiv i planifikimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Mbështetur në dokumentin në dispozicion, opinioni i marrë nga stafi i IAL-së dhe vëzhgimet gjatë vizitës në institucion krijohet bindja se UNIKO harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatorë. UNIKO ka tashme të hartuar, miratuar dhe konsoliduar planin për zhvillimin strategjik, Statut, Rregullore (IAL, njësie kryesore, program studimi). Këto aspekte garantojnë ligshmëri në vazhdimësi në kuadër të ligjit të Arsimit të Lartë (80/2015). Në nenin 9, Pika i, të rregullores së njësisë bazë janë përgjegjëse, përcaktohet se kjo njësi shqyrton dhe propozon kuota dhe kriteret të pranimit për çdo vit akademik. Këto propozime, pas miratimit nga Senati Akademik, i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) për miratim, duke marrë parasysh standardet. Punonjësit ndihmës-akademik dhe administrativ në departamente angazhohen në ofrimin e shërbimeve informuese dhe këshillimore ndaj studentëve. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 9, Pika i;</i>
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Krahas dokumenteve të tjerë, në Nenet 35 dhe 38 të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FB. Studimet për ciklin e dytë janë të aksesueshme për shtetas shqiptarë, shqiptarët etnikë që jetojnë jashtë Shqipërisë, si dhe për shtetas të huaj, duke ndjekur kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), si dhe nga Statuti dhe Rregullorja e UNIKO (shiko Neni 36 të rregullores së sipër-përmendur.

	<i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Sikundër parashikohet në Nenin 9 të Rregullores së Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, si edhe Neni 35 të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FB, njësia bazë shqyrton dhe sugjeron kuotat dhe kriteret për pranimin e aplikantëve në çdo vit akademik. Këto propozime realizohen nga njësia bazë (DA), në bashkëpunim me njësinë kryesore (FB), dhe miratohen nga Senati Akademik. Më pas, UNIKO i dërgon MAS për miratim kuotat dhe kriteret për pranime çdo vit. Pranohen në këtë program studimi kandidatët që kanë përfunduar një program Bachelor, si dhe ata që kanë një diplomë të ngjashme jashtë vendit, me kusht që diploma të jetë ekuivalentuar nga komisioni i duhur në MAS. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i> <i>Shtojca 2.3 Rregullore e Njesisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat pasqyrohen në rregulloren e Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" në Korçë (shiko Nenet 46, 47), Rregullorja për Organizimin dhe Veprimtarinë Mësimore, Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Bujqësisë (Shiko neni 35). Informacioni shpërndahet përmes promovimeve në shkolla për maturanët, duke u përqendruar te kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve. Studentët e regjistruar informohen me fletëpalosje dhe verbalizime për ecurinë e studimeve, transferimin, njohjen e kurseve profesionale, vlerësimin e dijeve dhe procesin e diplomimit. Kjo siguron qartësi dhe akses mbi të gjitha aspektet kryesore të programit të studimit. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon	Universiteti "Fan S. Noli" (UNIKO) përditëson rregullisht faqen e tij zyrtare, ee.unkorce.edu.al, në shqip dhe anglisht, duke ofruar informacione mbi aktivitetet akademike, programet e studimit,



publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	rregulloret dhe njoftimet për studentët. Monitorë dhe stenda në fakultete ofrojnë orientime, ndërsa informacione shtesë shpërndahen përmes guidave, broshurave dhe postimeve në rrjete sociale si Facebook e Instagram. Programi i transparencës përfshin korniza ligjore dhe veprimtari akademike e administrative, duke ofruar qasje të plotë për studentët dhe publikun e interesuar. Njoftime mbi pranimet, tarifat, transferimet dhe mobilitetin publikohen rregullisht. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> ëëë.unkorce.edu.al/archive/programi_transparences/programi_i_transparences.php <i>Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i> <i>Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025;</i> http://unkorce.edu.al/guida-uniko/ <i>Kriteret e pranimet - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Universiteti "Fan S. Noli" (UNIKO) mbështet integrimin e individëve me aftësi të veçanta dhe shtresave sociale në nevojë, duke siguruar kuota të dedikuara për ta në programet e studimit. Studentët e marginalizuar përjashtohen nga tarifat e shkollimit, ndërsa staf i akademik ofron ndjeshmëri dhe mbështetje për përfshirjen e tyre. Fakulteti i Bujqësisë përcakton kuota të veçanta për studentët me aftësi të kufizuara dhe nga pakicat, përfshirë masterin "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm". <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 3.21.1 Shkresë nr. 19 prot, datë 07.01.2025 "Propozim për Kuotat e Pranimet të Studentëve 2024-2025"</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Ky aspekt është i parashikuar në nenin 35, të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore në FB. Ky IAL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret baze dhe ato shtesë për përzgjedhjen e kandidatëve, përfshirë dhe ata me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i>

	<i>Shtojca 2.2 Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i> <i>Shtojca 3.21.1 Shkresë nr. 19 prot, datë 07.01.2025 "Propozimi për Kriteret e Pranimi të Studentëve 2024-2025;</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti "Fan S. Noli" (UNIKO) promovon integrimin e individëve me nevoja të veçanta në studimet universitare. Njësia "Agrobiznes" ofron kuota për kandidatët nga shtresat sociale në nevojë, përfshirë komunitetin rom dhe egjiptian. Këta studentë dhe jetimët përjashtohen nga tarifat shkollore, ndërsa stafi akademik siguron mbështetje të plotë. Sikundër parashikohet në nenin 34, të Statutit të UNIKO, studentët mund të përfitojnë bursa dhe shpërblime speciale, sipas kriterëve të ligjit dhe miratimeve nga Bordi i Administrimit të UNIKO-së. Reference; <i>Vizita në ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.2 Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i> https://unkorce.edu.al/?s=financiare&post_type=post <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë</i>			
Konkluzione	UNIKO harton dhe zbaton politika dhe procedura të strukturuar që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, duke siguruar ligjshmëri dhe qartësi përmes dokumenteve të konsoliduara si statuti, rregulloret dhe plani strategjik. Institucioni ofron kuota për studentët e marginalizuar dhe me nevoja të veçanta, duke i përjashtuar nga tarifat dhe ofruar mbështetje aktive. Informacioni publik distribuohet përmes faqes zyrtare, rrjeteve sociale dhe fletëpalosjeve. Pavarësisht përparimeve, sfida mbetet harmonizimi i kërkesave të studentëve me nevojat e tregut dhe zbatimi efektiv i strategjive.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni ka zhvilluar rregullore në nivel institucional dhe për programe të posaçme, që trajtojnë përparimin akademik dhe diplomimin. Këto përmbajnë informacion mbi gjithë ciklin akademik, përfshirë kriteret e pranimit. Planet mësimore dhe syllabuset ofrojnë detaje mbi kohëzgjatjen e lëndës, detyrimet dhe kriteret e vlerësimit. Studentët informohen që në javën e parë dhe gjatë vitit akademik përmes pedagogëve dhe burimeve në faqen zyrtare të institucionit. Studimet në programin e ciklit të dytë (MP) zgjasin 1 vit akademik. Statuti i UNIKO-s dhe rregulloret përkatëse përmbajnë udhëzime për kohëzgjatjen dhe kushtet për përparim akademik. Dokumentet janë publikuar në faqen zyrtare dhe janë lehtësisht të aksesueshme. Në fillim të çdo viti akademik, drejtuesit organizojnë takime për informimin e studentëve mbi kriteret dhe procedurat. Informacione të detajuara mund të merren në zyrat përkatëse, ndërsa pedagogët publikojnë syllabus-in për lëndët/modulet, duke përfshirë detaje mbi kreditet, vlerësimin dhe përmbajtjen. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> https://unkorce.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Ky kriter përmbushet në bazë të një procedure të mirë-përcaktuar, sipas rregullores së ekuivalentimeve. Janë të qarta procedurat dhe dokumentacioni i kërkuar, si vërtetimi i notave, syllabuset e lëndëve të ndjekura dhe çregjistrimi nga institucioni i mëparshëm. Informacioni shpërndahet përmes fushatave të drejtpërdrejta me studentët, medias sociale dhe faqes zyrtare të internetit. Në Fakultetin e Bujqësisë formohen komisione ad-hoc, me urdhër të Dekanit, për njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve. Departamentet dhe fakultetet përcaktojnë fushat e përafërta për transferime, të cilat kryhen kryesisht në vite të ndërmjetme për kandidatët me rezultate të larta, në bazë të kuotave të miratuara. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> https://unkorce.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive	Ky aspekt qartësohet në Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, në nenin 53 të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, si edhe në rregulloren e Programit të Studimit (MP) në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” 2024 – 2025.

të studentëve në programin e studimit.	Personeli akademik dhe ai ndihmës i Departamentit ofrojnë mbështetje për studentët, duke siguruar udhëzime dhe materiale të nevojshme për përgatitjen e provimeve përfundimtare dhe mbrojtjen e diplomës. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i> <i>Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025;</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Përgjegjësi i Departamentit dhe personeli akademik mbështesin studentët duke ofruar udhëzime dhe materiale për provimet përfundimtare dhe mbrojtjen e diplomës. Rregullorja e njësisë bazë dhe e programit "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm," në bashkëpunim me Universitetin e Plovdivit, përcakton procedurat e diplomimit. Pas përfundimit të studimeve, studenti përfiton "DIPLOMË UNIVERSITARE" përmes mbrojtjes së tezës ose provimit formues. Departamenti përcakton temat e diplomës dhe pedagogët udhëheqës, duke stimuluar mendimin logjik dhe shmangur riprodhimin mekanik. Takime informuese zhvillohen çdo fillim viti akademik për të sqaruar procedurat. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025;</i> <i>Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025;</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Departamenti i Agrobiznesit, në bashkëpunim me Fakultetin e Bujqesise, UNIKO-n dhe Qendrën e Kërkimeve dhe Arsimimit (QKA), organizon takime për të informuar studentët mbi programet e studimit dhe nevojat e tyre. Objektivat e qarta të kurrikulave, të drejtat dhe detyrat e studentëve, sistemi i vlerësimit, rregulloret e studimeve dhe detajet e programeve janë të aksesueshme në faqen e internetit të universitetit. Kandidatët mund të marrin informacion mbi kriteret e pranimit përmes faqes zyrtare ose fletëpalosjeve dhe të kontaktojnë personat përgjegjës nëpërmjet email-it ose telefonit. <i>Reference;</i>

	Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin https://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/udherefyysi2020.pdf http://unkorce.edu.al/programet-e-studimit-2/; http://unkorce.edu.al/programet-e-studimit-2/ Shtojca 4 Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit (Materiale promovuese, shtojca 4.3); https://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/udherefyysi2020.pdf			
Konkluzione	UNIKO ka zhvilluar rregullore dhe udhëzime të qarta për përparimin akademik dhe diplomimin, duke ofruar informacione gjithëpërfshirëse mbi ciklin e studimeve dhe kriteret e pranimit. Përmes faqes zyrtare, fushatave informuese, mediave sociale dhe takimeve akademike, studentët marrin detaje mbi programet e studimit, rregulloret, sistemin e vlerësimit dhe procedurat e diplomimit. Komisionet ad-hoc garantojnë procesin e ekuivalentimit, ndërsa stafi akademik siguron mbështetje gjatë provimeve përfundimtare dhe përgatitjes së diplomës. Sfida mbetet implementimi efektiv dhe inovativ për të rritur cilësinë..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Bazuar në intervistat gjatë vizitës dhe në procedurat e përcaktuara nga Statuti dhe rregulloret e programit, informimi realizohet përmes fushatave të drejtpërdrejta me studentët, medias sociale dhe faqes zyrtare të internetit. Në këtë proces janë aktivisht të angazhuar stafi i departamentit dhe strukturat e tjera të IAL. Departamenti i Agrobiznesit, së bashku me Fakultetin e Bujqësisë, UNIKO-n dhe Qendrën e Karrierës dhe Alumnin (QKA), zhvillon takime informuese. Këto takime synojnë të ofrojnë informacion mbi përmbajtjen e programeve të studimit, nevojat arsimore të studentëve, organizimin dhe kohëzgjatjen e tyre.
	Reference; Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin https://unkorce.edu.al/

Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	UNIKO ofron studentëve të programit Master profesional në “Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm” udhëzime dhe dokumente, si rregullorja, plani mësimor dhe programet lëndore. Programi i transparencës përfshin informacion mbi veprimtaritë akademike, administrative dhe ligjore. Studentët marrin njoftime të rregullta përmes faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale, për çështje të rëndësishme si pranimi, regjistrimi, tarifat, transferimi, mobilitetet dhe veprimtaritë studentore. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Stafi akademik i FB dhe DA, me Qendrën e Karrierës, angazhohen në orientimin e studentëve drejt tregut të punës dhe menaxhimit të karrierës së tyre. Qendra ka krijuar një sistem për administrimin e të dhënave mbi punësimin dhe analizat statistikore. Përmes rrjetit të komunikimit institucional, mbledhin dhe administrohen të dhëna mbi punësimin dhe nevojat e tregut. Stafi akademik ndihmon përmes referencave, ndërsa Qendra e Karrierës njofton në kohë reale studentët për mundësitë e punësimit. <i>Reference:</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 3.12.1 Strategjia e studimit të tregut të punës;</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Spektori i Studimeve dhe TIK përpunon dhe transmeton të dhënat akademike, nga regjistrimi deri në diplomim. Informacionet kryesore për pranimet, regjistrimin, tarifat, transferimet dhe njoftimet ndahen përmes faqes zyrtare, rrjeteve sociale, stendave dhe monitorëve në fakultet. Studentët marrin detaje të personalizuar për programet e studimit, kurset dhe rezultatet përmes platformës dixhitale Pitagora. Ambientet e Fakultetit të Bujqësisë janë të pajisura me tabela orientuese dhe monitorë për njoftime, ndërsa zyrat e informimit dhe sekretaritë ofrojnë sqarime shtesë. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>ëëë.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit,</i> <i>http://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf,</i> <i>https://ëëë.unkorce.edu.al/tarifet-e-sherbimeve,</i> <i>https://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/Studentet%20qe%20perjashtohen%20nga%20tarifat.pdf,</i>

	https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4017993801558643 , https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4025316040826419 , https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4077439475614075 , https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4095984270426262) Shtojca 1.6 Manual i sistemit elektronik PITAGORA;			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni përdor platformën dixhitale "Pitagora," ku studentët mund të gjejnë detaje të personalizuar si kurrikula, rezultatet e provimeve dhe organizimi i studimeve. Për më tepër, informacionet e rëndësishme publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale të UNIKO-s, duke garantuar akses të shpejtë dhe të vazhdueshëm. <i>Reference;</i> Vizita në ambientet e IAL dhe intervista me stafin Shtojca 1.6 Manual i sistemit elektronik PITAGORA; (ëëë.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimi, http://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf ,			
Konkluzione	UNIKO siguron informim të gjerë për studentët përmes platformës dixhitale "Pitagora," faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale. Takimet informuese nga Fakulteti i Bujqësisë, Departamenti i Agrobiznesit dhe Qendra e Karrierës ndihmojnë në prezantimin e programeve të studimit dhe mundësive profesionale. Transparenca promovohet përmes rregulloreve, dokumenteve dhe njoftimeve mbi aktivitetet akademike. Institucioni menaxhon të dhëna akademike me kujdes, duke përdorur analiza statistikore dhe duke orientuar studentët drejt tregut të punës me sistemet e mirë-koordinuara të komunikimit dhe informimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon të dhënat akademike nga regjistrimi deri te diplomimi i studentëve, duke përpunuar dhe transmetuar informacionin në përputhje me aktet nënligjore. Ai koordinon të dhënat me administratën dhe siguron mirëmbajtjen e platformës dixhitale të universitetit. Sektori përpunon statistika

	dhe ndan informacion me njësitë e universitetit, MAS dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK;</i> https:// ëëë.unkorce.pitagora.u-gov.rash.al/ <i>Shtojca 3.19 Model program i shkurtuar;</i> <i>(ëëë.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit,</i> http:// ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf, https:// ëëë.unkorce.edu.al/tarifet-e-sherbimeve, https:// ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/Studentet%20qe%20perjashtohen%20nga%20tarifat.pdf, https:// ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4017993801558643, https:// ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4025316040826419, https:// ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4077439475614075, https:// ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4095984270426262)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon të dhënat akademike që nga regjistrimi deri në diplomim, duke bashkëpunuar me administratën për mbledhjen dhe përpunimin e tyre. Ai administron platformën dixhitale të të dhënave të universitetit dhe siguron komunikim efikas. Informacionet ndahen me njësitë e universitetit, MAS dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve. Studentët informohen nëpërmjet faqes zyrtare, rrjeteve sociale dhe stendave për çështje të rëndësishme akademike. Sekretaria Mësimore përpunon të dhëna statistikore mbi regjistrimet dhe diplomimet, duke i ndarë ato me njësitë bazë dhe kryesore për analizat vjetore. Numri i studenteve ne dy vite jete te këtij program Studimi, eshte si vijon: • 2023-2024 4 studente • 2024-2025 2 studente <i>Reference;;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> https://unk.pitagora.rash.al/login 417 (www.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit, http:// www.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf, https:// www.unkorce.edu.al/tarifet-e-sherbimeve,



	https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/Studentet%20qe%20perja%20shohen%20nga%20tarifat.pdf, https://www.facebook.com/unkorce/posts/4017993801558643, https://www.facebook.com/unkorce/posts/4025316040826419, https://www.facebook.com/unkorce/posts/4077439475614075, https://www.facebook.com/unkorce/posts/4095984270426262) 418 Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2023-2024;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat personale të studentëve përpunohen dhe ruhen me konfidencialitet, sipas legjislacionit dhe rregullores së brendshme të universitetit. Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon sistemin për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave akademike, duke bashkëpunuar me administratën e Rektoratit. Informacioni përcillet në sistemet e Ministrisë së Arsimit dhe Agjencisë Kombëtare të Provimeve. Studentët përdorin platformën "Pitagora" për të aksesuar në mënyrë konfidenciale të dhëna individuale, duke përfshirë vlerësimet dhe progresin akademik. Kjo platformë siguron përditësime të vazhdueshme dhe akses efikas për të gjithë studentët. <i>Reference;</i> Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale; 421 Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK; 422 Shtojca 1.6 Manual i sistemit elektronik PITAGORA;
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA) mat treguesit kryesorë të performancës dhe harton plane për përmirësime. Aktivitetet e tij përshkruhen në Manualin e Cilësisë dhe detajohen në planin kalendarik. Ai koordinon punën me NJSBC, sekretaritë mësimore dhe raporton te autoritetet drejtuese, duke kryer vlerësime periodike të efikasitetit të veprimtarive mësimore. Sekretaria mësimore siguron dokumentimin dhe saktësinë e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetet e tyre. SKVIA ka pavarësi veprimi dhe akses në të dhënat e universitetit. <i>Reference;</i> Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin

	<i>Shtojca 3.4 Raport i kontrollit të ushtruar për dokumentacionin mësimor;</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO;</i> <i>Shtojca 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional;</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë “Agrobiznes” harton raporte analitike vjetore mbi veprimtarinë akademike, duke analizuar cilësinë e studentëve dhe mundësitë e punësimit të tyre. Këto raporte diskutohen në takime me stafin akademik dhe ndihmës-akademik, më pas integrohen në analizat studimore të njësisë kryesore (FB). Kjo lejon realizimin e një analize krahasuese midis njësive bazë dhe programeve të ndryshme që ofrohen nga Fakulteti i Bujqësisë. <i>Reference;</i> <i>Vizita në ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;</i> <i>Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2023-2024;</i>			
Konkluzione	Sektori i Studimeve dhe TIK në UNIKO menaxhon të dhënat akademike duke siguruar administrimin efikas përmes platformës dixhitale “Pitagora.” Ai koordinon të dhënat me administratën dhe institucione të tjera, duke respektuar konfidencialitetin sipas legjislacionit. Informacioni është i aksesueshëm dhe i përditësuar përmes platformës dixhitale, rrjeteve sociale dhe stendave informuese. SKVIA mat performancën dhe harton plane për përmirësime. Pavarësisht përpjekjeve, sfida mbetet zbatimi praktik dhe përmirësimi i vazhdueshëm për të harmonizuar sistemin me kërkesat akademike dhe administrative.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve	Bazuar në Statutin (Neni 80), Rregulloren e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB (Neni 94), dhe intervistat gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, studentët

dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	përfaqësohen në Senat, në NJSBC dhe përmes këshillave studentorë të vet-organizuar. Në nivel institucional, Zyra e Studentëve dhe e Këshillimit të Karrierës koordinon këto këshilla dhe procesin e këshillimit të studentëve. Gjithashtu, pranë KUB funksionon qeveria studentore, e cila mbron zërin dhe interesat e studentëve në vendimmarrje. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë,;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët luajnë rol në jetën institucionale të UNIKO-s përmes përfaqësimit aktiv në organet vendimmarrëse. Ata marrin pjesë në Senatin Akademik dhe kanë një përfaqësues në Bordin e Administrimit. Gjithashtu, studentët përfaqësohen në njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Këshillat studentorë koordinojnë përfaqësimin e tyre, duke paraqitur propozime për planet e studimeve, rregulloret, tarifat, cilësinë e shërbimeve dhe veprimtaritë kulturore. Me të drejtë të plotë vote, studentët janë të përfaqësuar në komisionet e përhershme në nivel njësie kryesore. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.12 Model - Anëtarësimi i studentëve në senatin akademik;</i> <i>Shtojca 3.11 Lista e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC);</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Neni 80, Pika 7;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 94, Pika 4;</i> <i>Shtojca 1.17 Rregullorja e Këshillit Studentor;</i> https://ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/3673764606006400, https://ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/4750545101661673, https://ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/4668063253243192,

	https:// ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/4634907479892103)
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	njësia përgjegjëse angazhohet në mënyrë të rregullt për të përfshirë studentët në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Kjo përfshirje realizohet përmes mbledhjeve të përbashkëta në departament, anketave me pyetësorë, grupeve fokusimi dhe mekanizmave të tjerë konsultativë. Sugjerimet dhe kontributet e studentëve analizohen dhe reflektohen në përmirësimet e programeve, duke siguruar që zëri i tyre të jetë pjesë e procesit vendimmarrës. Kjo praktikë ndihmon në zhvillimin e vazhdueshëm dhe përshtatjen e kurrikulave me nevojat e studentëve dhe tregut të punës. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.17 Rregullorja e Këshillit Studentor;</i> <i>(https:// ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/3673764606006400,</i> <i>https:// ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/4750545101661673,</i> <i>https://ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/4668063253243192,</i> <i>https://ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/4634907479892103)</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Neni 80;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 94, Pika 4;</i> <i>Shtojca 3.13 Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor;</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	DA dhe Dekani i FB kryejnë rregullisht anketime për cilësinë e mësimdhënies në modulet e programeve të njësisë bazë "Agrobiznes". Studentët, përmes pyetësorëve, japin opinione, qëndrime dhe sugjerime për përmirësimin e programeve të studimit. Ata shprehin mendime për planet, rregulloret dhe veprimtaritë mësimore, si dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Kjo ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë mësimore dhe akademike. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i>



	<i>Shtojca 3.13 Pyetësi i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor;</i> <i>441 Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësit me studentët</i>			
Konkluzione	<i>Studentët në UNIKO janë pjesë aktive e strukturave vendimmarrëse, duke përfshirë Senatin Akademik, Bordin e Administrimit, njësitë e sigurimit të cilësisë dhe komisionet e përhershme. Përfaqësimi i tyre realizohet përmes këshillave studentorë dhe mekanizmave konsultativë si pyetësit, grupet fokusimi dhe mbledhjet departamentale. Sugjerimet e studentëve ndihmojnë në hartimin e kurrikulave dhe përmirësimin e veprimtarive akademike. Megjithatë, sfida kryesore mbetet zbatimi i tyre në mënyrë efektive për të harmonizuar nevojat e studentëve me standardet akademike dhe tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UNIKO është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), që integron sisteme dixhitale për administrimin e të dhënave. Përmes sistemit "Pitagora", UNIKO rrit efikasitetin në administrimin e informacionit, duke ofruar shërbime sekretarie, grafikun e provimeve, rezultatet, kurrikulat dhe planet lëndore në kohë reale. Ky sistem është i aksesueshëm për studentët dhe stafin nga çdo vend përmes llogarive personale, si dhe nga faqja zyrtare ëëë.unkorce.edu.al, e përditësuar me informacion në shqip dhe anglisht mbi aktivitetin akademik dhe administrativ. Programi i Transparencës pasqyron veprimtarinë e universitetit, marrëdhëniet me publikun dhe kornizën ligjore. Ndërkohë, paketa "Office 365" lehtëson komunikimin përmes adresave elektronike @unkorce.edu.al. Monitorët dhe stendat informuese në fakultete, si dhe broshurat dhe rrjetet sociale, ndihmojnë në informimin e vazhdueshëm të studentëve dhe palëve të interesuara mbi aktivitetet e UNIKO. <i>Reference;</i>

	<i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.6.1 Marrëveshja me RASH për sistemin PITAGORA;</i> https://unk.pitagora.rash.al/ <i>Shtojca 2.23 Raport Instalimi i projektit OFFICE 365;</i> http://unkorce.edu.al/guida-uniko/ http://unkorce.edu.al/kendi-i-maturanteve/
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni UNIKO ka ngritur dhe funksionalizuar një sistem të organizuar informacioni për t'i asistuar studentët në procesin mësimor dhe në lidhje me programet e studimit. Informacioni i detajuar për kurrikulën, stafin akademik, rezultatet e provimeve dhe të të nxëniet është i aksesueshëm për studentët përmes platformës dixhitale "Pitagora", përmes llogarive të tyre personale. Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon të dhënat që lidhen me veprimtarinë akademike, nga regjistrimi i studentëve deri në diplomim. Për më tepër, UNIKO informon rregullisht studentët përmes faqes së internetit dhe rrjeteve sociale mbi pranime, tarifat, transferimet dhe veprimtaritë akademike. Qendra e Karrierës organizon trajnime dhe aktivitete për zhvillimin profesional të studentëve, duke përfshirë ndihmën për aplikimet e mobilitetit dhe transferimin e krediteve. Informacioni shtesë ofrohet në stenda dhe monitorë në fakultet ose përmes zyrës së informimit dhe sekretarisë së departamenteve. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB</i> <i>Shtojca 1.6 Manual i sistemit elektronik PITAGORA</i> <i>(ëëë.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit,</i> <i>http://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf,</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit	Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës përmes Qendrës së Karrierës, e cila funksionon si një urë lidhëse mes tregut të punës dhe UNIKO. Në fillim të çdo viti akademik, Qendra organizon takime informuese për studentët e vitit të parë, ku prezanton organizimin e studimeve, të drejtat dhe detyrat e tyre, sistemin e krediteve dhe informacione të tjera kyçe. Qendra e Karrierës gjithashtu njofton studentët aktualë dhe ata të diplomuar për mundësi punësimi në kohë reale, duke bashkëpunuar me agjenci punësimi. Për më tepër, ajo përgatit broshura dhe fletëpalosje që ndihmojnë në informimin dhe

mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	orientimin për zhvillimin e karrierës. Ky shërbim, i menaxhuar në bashkëpunim me Sektorin e Studimeve dhe atë të Kurrikulës, është i vazhdueshëm dhe i përditësuar për të adresuar nevojat e studentëve. Megjithatë, mbetet sfida lehtësimi i lidhjes me konkrete të tregut të punës me studentet. Kështu me konkretisht, nuk krijohet bindja që stafi i mbështetjes për karrierën të arrijë të ofrojë këshillim ndaj studenteve (si të aplikojnë për [une, si të gjejnë informacion, si të përpiljnë një CV, si të sillen në një intervistë, cilat janë platformat e punësimit etj.) dhe për rrjedhojë duke mbajtur evidence për këtë qëllim. Ky është një aspekt i rëndësishëm në lehtësimin e hyrjes në treg për studentet e FB. <i>Reference;</i> <i>Vizita në ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Po, Zyra e Karrierës ndjek studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Në bashkëpunim me SKVIA dhe stafin akademik të DA, Qendra e Karrierës organizon trajnime dhe aktivitete periodike për studentët. Gjatë këtyre aktiviteteve, studentët marrin udhëzime mbi zhvillimin e karrierës, hartimin e CV-ve, dosjeve personale dhe prezantimin gjatë intervistave. Dy herë në vit, organizohen takime me institucione të sektorit publik dhe privat, ku studentët aktualë dhe të diplomuar marrin pjesë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre dhe për të krijuar lidhje me tregun e punës. Qendra e Karrierës gjithashtu krijon mundësi për praktikë profesionale dhe stazhe, duke u bazuar në projekte kombëtare dhe duke ndihmuar në krijimin e marrëdhënieve të reja ndërmjet UNIKO-s dhe institucioneve përkatëse. Ky proces është një bazë e vlefshme për studentët dhe drejtuesit e universitetit. <i>Reference;</i> <i>Vizita në ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 3.10 Praktika e Organizimit të Tryezave të Përbashkëta me Operatorët e Sektorit Publik/Privat;</i> https://ëëë.facebook.com/unforce/posts/5058027830888563
Konkluzione	UNIKO ka integruar sisteme dixhitale për administrim të dhënash si "Pitagora," duke rritur aksesin në informacion akademik

	përmes platformave dixhitale dhe transparencës së veprimtarive në faqen zyrtare. Institucioni promovon komunikim efektiv përmes "Office 365" dhe rrjeteve sociale, ndërsa Qendra e Karrierës ofron mbështetje për zhvillimin profesional, duke ndjekur studentët pas diplomimit. Pavarësisht përparimeve, sfidat mbeten në zbatimin praktik të mekanizmave dhe krijimin e lidhjeve më të forta me tregun për avancimin e kërkimit dhe aftësive pedagogjike. Po ashtu stafi i mbështetjes për karrierën nuk arrin të ofrojë këshillim ndaj studenteve dhe për rrjedhojë duke mbajtur evidence për kete qellim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni harton dhe përdor udhëzues për zhvillimin dhe zbatimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në Fakultetin e Bujqësisë (FB), metodat e mësimdhënies ndërthurin elementë si leksionet, seminarët, praktikat laboratorike dhe diskutimet. Institucioni integron teknologjinë e informacionit përmes përdorimit të pajisjeve audiovizuale si Smartboard, All in One Interactive Flat Panels dhe Video-projektorë, të cilat janë instaluar në çdo klasë ose auditor. Raportet vjetore theksojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies duke përdorur teknologjitë më të fundit dhe promovimin e kualifikimit të stafit akademik për të rritur aftësitë pedagogjike. Këto masa përmirësojnë vazhdimisht efikasitetin e mësimdhënies dhe përmbushjen e objektivave të kurrikulës. <i>Reference;</i>

	<i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 4 Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit (Tabela 16, 17);</i> <i>Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	strukturat përgjegjëse në UNIKO zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. SKVIA dhe njësitë bazë fokusohen në zhvillimin e kurrikulave sipas standardeve dhe në sigurimin e cilësisë përmes procedurave të mirë-përcaktuara. Treguesit e performancës maten përmes raportit të vetëvlerësimit, monitorimit të dokumentacionit, anketave dhe pyetësorëve, si dhe përcaktimit të rekomandimeve për përmirësim. NJSBC, në bashkëpunim me këshillin studentor, realizon vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes pyetësorëve të përgjithshëm. Për më tepër, performanca e stafit analizohet në kuadër të arritjeve akademike dhe kërkimore përmes analizave vjetore të departamentit, sipas modelit të manualit të cilësisë. Këto mekanizma ndihmojnë në garantimin dhe rritjen e cilësisë së ofertës akademike. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO (Relacioni);</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO;</i> <i>Shtojca 3.13 Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor;</i> <i>Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO fq. 32-35;</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Po, institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, si dhe të vlerësimit të dijeve, duke përfshirë trajtimin e ankimimeve. Çdo tre muaj, Dekani i FB dhe autoritete të tjera drejtuese në UNIKO organizojnë takime pune me përfaqësuesit e këshillave studentorë dhe drejtuesit e njësive bazë. Gjatë këtyre takimeve, diskutohen dhe shkëmbehen ide mbi përmirësimin e programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe mënyrave të vlerësimit të dijeve, duke reflektuar sugjerimet e studentëve.

	Anketime periodike realizohen nga DA për cilësinë e mësimdhënies në modulet e programeve të studimit. Përmes pyetësorëve, studentët shprehin qëndrimet dhe sugjerimet e tyre mbi metodat e përdorura, barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit. Rezultatet e këtyre anketimeve diskutohen në mbledhjet e Dekanatit dhe departamenteve, me synimin për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe infrastrukturës arsimore. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i> <i>Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Strukturat përgjegjëse në UNIKO bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie, kryesisht në mbledhje në nivel njësie bazë. Njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës mbledhin dhe analizojnë perceptimet e studentëve përmes pyetësorëve, duke adresuar metodologjinë e mësimdhënies dhe përmbajtjen akademike. Rezultatet e këtyre pyetësorëve diskutohen në mbledhjet e Dekanateve dhe departamenteve, duke nxitur përmirësimin e kurrikulave, metodave të mësimdhënies dhe infrastrukturës. Në fund të çdo viti, rezultatet e auditimit dhe analizat vjetore të punës prezantohen në takime të hapura me pjesëmarrjen e gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve. Këto rezultate publikohen gjithashtu në Programin e Transparencës në faqen zyrtare të internetit, duke garantuar aksesin për të gjitha palët e interesuara. <i>Reference;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 3.13 Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor;</i> <i>Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i> http://unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për	Ndërkombëtarizimi, që është një nga mënyrat e rritjes së performancës së institucionit, dhe për rrjedhojë të motivimit të stafit, mbetet një përprjekje e vonuar. Politikat integruese, trajnimet dhe vitet sabbatike janë hapa pozitivë, <i>por nevojitet një angazhim më i thellë për rritjen e impaktit në tregun global të punës dhe për avancimin e kërkimit shkencor në nivel ndërkombëtar, e për rrjedhojë një performancë më e mirë në mësimdhënie.</i>

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referencë; <i>Shtojca 1.20 Rregullore për rregullat dhe standardet e përfitimit të së drejtës për vitin akademik sabatik;</i> <i>Shtojca 2.10.1 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale;</i> <i>Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;</i>			
Konkluzione	UNIKO ka ndërtuar procedura dhe udhëzues për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies, duke integruar teknologji moderne dhe trajnuar stafin akademik për efikasitet pedagogjik. Struktura të tilla si NjSBC dhe SKVIA monitorojnë aftësitë e stafit dhe perceptimet e studentëve, duke përdorur pyetësorë dhe analiza periodike për përmirësim të vazhdueshëm. Ndërkombëtarizimi, megjithëse i vonuar, mund të rrisë performancën dhe ndikimin global. Sfidat mbetet zbatimi praktik i masave të propozuara dhe rritja e harmonizimit të kurrikulave me tregun dhe kërkesat teknologjike..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UNIKO mbështetet në baza ligjore dhe procedurale solide, por zbatimi praktik mbetet një sfidë. Politikat aktuale dhe standardet, ndonëse të përshkruara qartë, kanë nevojë për një analizë më të thellë për të përshtatur kërkesat me tregun dhe teknologjinë. Përfshirja e aktorëve kryesorë dhe analizat mbi pyetësorët e studentëve mund të ndihmojnë në hartimin e kurrikulave më të përshtatshme. Gjithashtu, rritja e aktiviteteve ndërkombëtare, trajnimeve janë hapa domethënës. Referencë; <i>Vizita në ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit 2022-2027;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 96;</i>

	<i>Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO;</i> <i>Shtojca 2.21 Gjurmimi i Ecurisë së Punësimit (Alumni);</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UNIKO ka struktura dhe udhëzime të sigurimit të cilësisë, por ndikimi i tyre mbetet i kufizuar për shkak të zbatimit të fragmentuar. Njësia SBSC luan një rol kyç në matjen e performancës dhe përmirësimin e programeve, duke koordinuar punën e fakulteteve dhe raportuar masat përkatëse. Studentët janë konsideruar elementë kryesorë, por roli i tyre kërkon thellim në zbatimin praktik. Plani Strategjik 2022-2027 synon harmonizimin e kurrikulave me tregun dhe rritjen e aftësive të studentëve, por sfidat infrastrukturore dhe të mobilitetit mbeten të pazgjidhura. UNIKO mund të përmirësojë ndikimin përmes modernizimit të metodave, teknologjisë dhe përfshirjes së aktorëve kryesorë, duke rritur cilësinë e diplomave dhe zgjeruar bashkëpunimet akademike dhe kërkimore. <i>Referencë;</i> <i>Vizita në ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO;</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë;</i> <i>Shtojca 3.16 Praktika e plotë e fushatës promovuese UNIKO ff. 9-10;</i> <i>https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4878612305496784</i> <i>Shtojca 3.16 Praktika e plotë e fushatës promovuese UNIKO;</i> <i>https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=ye5xNm90cM4</i> <i>https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4943260422365305</i> <i>https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=ye5xNm90cM4</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Kreu VIII;</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve	Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit në UNIKO koordinon zhvillimin e kurrikulave dhe procedurat e sigurimit të cilësisë. Ajo krijon, monitoron dhe propozon masa për përmirësimin e standardeve akademike, duke përdorur vetëvlerësimin, pyetësorët dhe analiza të performancës së stafit e studentëve. SKVIA mat treguesit kyç të performancës dhe harton plane veprimi, por zbatimi praktik shpesh mbetet sfidë. Akreditimi institucional është arritur, por programet kërkojnë përmirësime për të rritur efektivitetin dhe

analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	përputhjen me tregun. Në veçanti, Departamenti i Agrobiznesit dhe programi “Menaxhimi i Qëndrueshëm në Agroturizëm” janë përfshirë në procese akreditimi që kërkojnë më shumë angazhim për të avancuar cilësinë e ofertës akademike dhe kërkimore. <i>Referencë;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO (Relacioni);</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO;</i> <i>Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO;</i> <i>Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Drejtoria e Kurrikulave, Vlerësimit dhe Institucional, përmes SKVIA, zhvillon dhe monitoron procedura për të përmirësuar standardet akademike. Synimet përfshijnë përmirësimin e strukturave, burimeve dhe cilësisë së mësimdhënies, të nxënit dhe kërkimit shkencor, bazuar në indikatorë të matshëm. Vlerësimi i performancës përfshin procesin mësimor, stafin, studentët dhe menaxhimin e brendshëm, sipas standardeve strategjike të UNIKO. Rezultatet, të përfshira në raportet vjetore, diskutohen me stafin akademik për të nxitur përmirësime dhe arritje të reja. Ndërsa përpjekjet janë të strukturuar, sfidat mbeten në zbatimin praktik dhe përshtatjen me tregun. Pavarësisht kësaj, përmirësimet e vazhdueshme janë një hap i rëndësishëm për avancimin e cilësisë akademike dhe kërkimore. <i>Referencë;</i> <i>Vizita ne ambientet e IAL dhe intervista me stafin</i> <i>Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore e FB për Vitin Akademik 2023-2024;</i> <i>Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;</i> <i>Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;</i>
Konkluzione	UNIKO mbështetet në baza ligjore solide dhe struktura të përcaktuara për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë analiza periodike dhe plane strategjike për harmonizimin e kurrikulave me tregun. Megjithatë, sfidat e zbatimit praktik dhe përshtatjes me nevojat teknologjike dhe infrastrukturore mbeten të pazgjidhura. Përfshirja aktive e aktorëve kryesorë dhe studentëve, rritja e mobilitetit dhe aktiviteteve ndërkombëtare, si dhe modernizimi i metodave janë të domosdoshme. Përmirësimi i vazhdueshëm i

	<i>standardeve akademike dhe kerkimit permes procedurave te mire-strukturuara dhe angazhimit kolektiv mbetet thelbësor për rritjen e cilësisë dhe ndikimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Ka një proces të strukturuar dhe i dokumentuar për rishikimin periodik të programeve të studimit të ciklit të dytë, që përputhet me kriteret e mekanizmave formale që i shërbejnë qëllimeve të akreditimit. Kuadri rregullator siguron që ky proces të jetë i kodifikuar përmes "Rregullores së Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore" dhe thekson përfshirjen e palëve të interesuara, veçanërisht dekani i fakultetit dhe një komision ad-hoc. Kjo tregon formalizimin, siç kërkohet nga kriteret, dhe siguron një bazë për transparencë dhe llogaridhënie. <i>Reference</i> <i>Intervista në IAL</i> <i>2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin	Raportet e analizës vjetore për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, të hartuar në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe në kuadrin e IAL-ve, përfshijnë një vlerësim gjithëpërfshirës të performancës së stafit dhe të aktivitetit në të gjitha aspektet, si mësimore ashtu edhe kërkimore, duke përfshirë edhe zhvillimin profesional të studentëve. Këto raporte pasqyrojnë si arritjet, ashtu edhe problematikat, duke u ndalur në analizën e

e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	shkaqeve përkatëse dhe duke sugjeruar masa specifike për përmirësim. Megjithatë, mungon qartësia në metodologjitë e vlerësimit dhe transparencën për efektivitetin e masave. Parashikimi i aktiviteteve për vitin e ardhshëm është pozitiv, por mungon përshtatshmëria me prioritetet strategjike dhe tregun e punës. Një analizë më e detajuar në këto aspekte do të sillte rezultate më të qëndrueshme dhe do të përmirësonte cilësinë e procesit. <i>Reference</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL</i> <i>Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore e FB për Vitin Akademik 2023-2024;</i> <i>Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;</i> http://unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2 <i>Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore e FB për Vitin Akademik 2023-2024;</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, teste lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në teste ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në UNIKO dhe FB, vlerësimi mbështetet në një metodologji të qartë për matjen e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë, duke përfshirë anketime dhe analiza krahasuese për të garantuar cilësinë. Sidoqoftë, mbetet sfida e dokumentimit rigoroz të ndikimit të masave të ndërmarra. Ndërkohë që leksionet e hapura dhe komisionet për vlerësimin e provimeve janë praktika pozitive, mbetet një nevojë për përshtatje më të mirë me nevojat e tregut të punës dhe një strategji më të qartë për të matur efektivitetin e përmirësimeve të propozuara. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL</i> <i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit 2022-2027;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i> <i>Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" 2024 – 2025;</i> <i>Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	Procesi i vlerësimit është i strukturuar dhe përfshin aktorë të ndryshëm, duke promovuar përmirësime të qëndrueshme. Megjithatë, mungon analiza e detajuar mbi efektivitetin e masave

cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	të propozuara dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me tregun e punës. Pavarësisht angazhimit në trajnime dhe rishikime periodike, qasja për monitorimin e ndikimit të këtyre aktiviteteve mbetet e paqartë. Përmirësimi i metodave për matjen e rezultateve dhe dokumentimi sistematik do të forconte procesin dhe përpunjen me objektivat strategjike. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i> <i>Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 113, Pika 1;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 113, Pika 2,3;</i> <i>Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i> <i>Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i>			
Konkluzione	<i>Procesi i vlerësimit është i dokumentuar dhe përputhet me kriteret e formalizimit, duke përfshirë aktorë të ndryshëm dhe analiza të detajuara. Megjithatë, ka nevojë për metodologji më të qarta vlerësimi dhe lidhje më të forta me prioritetet strategjike dhe tregun e punës. Përmirësimi i transparencës dhe monitorimit të ndikimit të masave të propozuara do të kontribuonte në një cilësi më të qëndrueshme dhe efektive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të	Roli i strukturave akademike dhe administrative në sigurimin e cilësisë është i strukturuar, duke përfshirë studentët dhe pedagogët në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve. Pavarësisht përpjekjeve, mungon një analizë e detajuar mbi efektivitetin e bashkëpunimeve dhe përpunjen e programeve me nevojat e tregut të punës. Tryezat e rrumbullakëta dhe bordet këshillimore janë hapa pozitivë, por kërkohet monitorim më i mirë i rezultateve dhe lidhje më strategjike me prioritetet rajonale.



cilësisë së programit të studimit.	<i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO;</i> <i>Shtojca 2.14 Vendimi për krijimin e Bordit Këshillimor;</i> <i>Shtojca 2.14 Vendimi për krijimin e Bordit Këshillimor;</i> <i>Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Nga shqyrtimi i Statutit të UNIKO (neni 84) përcaktohet një strukturë të qartë dhe të organizuar për sigurimin e cilësisë, përmes DKVIA-së dhe NJSC-ve. Fokusimi në kontrollet periodike dhe leksionet e hapura është pozitiv, por mungon qartësia mbi ndikimin konkret të këtyre aktiviteteve në rritjen e cilësisë. Përmirësimi i metodave të monitorimit dhe një analizë më e thellë mbi performancën e programeve do të përforconte më tej procesin, duke e bërë atë më efektiv dhe në përputhje me tregun e punës. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Kreu IX, Neni 84;</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës-akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në UNIKO, rrjeti i strukturave për sigurimin e cilësisë funksionon në mënyrë të organizuar, duke përfshirë dokumentim të qartë dhe analizë të dhënave nga anketime dhe raporte. Nxitja e përfshirjes së studentëve dhe stafit akademik është pozitive, por kërkohet qartësi mbi lidhjen e këtyre masave me prioritetet strategjike dhe nevojat konkrete të tregut të punës. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i> <i>Shtojca 3.7 Raporti vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë;</i> <i>Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore e FB për Vitin Akademik 2023-2024;</i> <i>Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Procesi i sigurimit të cilësisë në UNIKO është gjithëpërfshirës dhe i bazuar në etikë, transparencë dhe standarde profesionale, duke përfshirë stafin akademik dhe studentët në cikle të rregullta vlerësimi. Hartimi i pyetësorëve dhe përpunimi i të dhënave respektojnë anonimat dhe shmangin diskriminimin. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i> <i>Shtojca 1.18 Rregullore e këshillit të etikës;</i>

	<i>Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i> <i>Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;</i> <i>Shtojca 3.7.1 Raporti Institucional i Vlerësimit të Brendshëm UNIKO (Relacion);</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	UNIKO dhe FB kanë krijuar partneritete efektive brenda dhe jashtë Shqipërisë për të rritur cilësinë e programeve të studimit përmes bashkëpunimeve me sektorin privat dhe publik. Tryezat e rrumbullakëta dhe vlerësimet nga ekspertët kanë ndihmuar në përditësimin e kurrikulave, duke adresuar nevojat e tregut të punës. Megjithatë, nevojitet një monitorim më i detajuar i ndikimit të këtyre iniciativave dhe forcimi i integritetit strategjik midis institucioneve akademike dhe tregut të punës për rezultate afatgjata. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i> <i>Shtojca 2.10.1 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale;</i> <i>Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;</i> <i>Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;</i> <i>Shtojca 3.10 Praktika e organizimit të tryezave të përbashkëta me operatorët e sektorit Publik/Privat;</i> <i>Shtojca 3.12 Studim Tregu për Programin e Studimit "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm";</i> <i>Shtojca 2.10.1 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale;</i>			
Konkluzione	Roli i strukturave akademike dhe administrative në UNIKO është i organizuar dhe përfshirës, duke përfshirë studentët dhe stafin në sigurimin e cilësisë. Megjithëse praktikat si tryezat e rrumbullakëta dhe vlerësimet nga ekspertët kanë sjellë përmirësime, mungon analiza e ndikimit të këtyre masave dhe përputhja me tregun e punës. Monitorimi më i detajuar dhe lidhja strategjike midis UNIKO/FB dhe sektorit privat do të forconte efektivitetin dhe ndikimin afatgjatë të nismave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë është një përbërës thelbësor i politikave dhe strategjive të strukturave si universitetet, fakultetet dhe departamentet. Këto aspekte mbështeten në dokumente të shumta të cilat janë publike dhe të lehtësisht të aksesueshme, si Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 531, datë 11.09.2018 që trajton “Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Statuti i UNIKO, Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2022-2027 dhe Rregullorja për Organizimin dhe Veprimtarinë Mësimore-Kërkimore Shkencore të UNIKO-s. Nga ana tjetër, Fakulteti i Bujqesise përdor instrumente matëse për të monitoruar progresin dhe cilësinë e procesit të mësimdhënies. Këto instrumente përfshijnë analizimin e literaturës së përdorur, metodologjitë e mësimdhënies të ndjekura nga pedagogët dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit, gjithmonë në përputhje me rregulloret dhe planet e miratuara. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i> <i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit 2022-2027;</i> <i>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit analizohen dhe diskutohen në takime specifike në nivel departamenti, ku evidentohen dobësitë dhe merren masa për përmirësimin e tyre. Po ashtu, edhe rezultatet e anketave të studentëve shqyrtohen në këto takime, duke ndihmuar në identifikimin e problematikave dhe zbatimin e ndryshimeve të nevojshme. Megjithatë, duhet theksuar se këtu lind nevoja për një balancë të kujdesshme midis transparencës dhe mbrojtjes së privatësisë. Nëse kjo balancë nuk zbatohet siç duhet, ekziston rreziku që rezultatet të mos jenë të aksesueshme mjaftueshëm për palët e interesuara, duke kufizuar kështu ndikimin pozitiv që këto procese mund të kenë për përmirësimin e cilësisë. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i> <i>Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;</i> <i>Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore e FB për Vitin Akademik 2023-2024;</i>

	Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO 2022-2023;
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në bashkëpunim të ngushtë me departamentet, përfshirë edhe Departamentin e Administratës (DA), Fakulteti i Biznesit harton dhe miraton në fillim të çdo viti akademik një plan veprimi. Ndërsa krijimi i një plani të tillë struktural është një hap pozitiv drejt përmirësimit, sfida mbetet tek zbatimi i tij në mënyrë efektive dhe mbikëqyrja e vazhdueshme për të garantuar që të gjitha masat e parashikuara të realizohen siç duhet. Ky proces kërkon jo vetëm përkushtim, por edhe angazhim të vazhdueshëm nga të gjitha palët e përfshira. Për më tepër, reflektimi mbi rezultatet e vitit të kaluar duhet të jetë sa më gjithëpërfshirës për të adresuar si dobësitë e përgjithshme, ashtu edhe ato specifike për programet. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista në IAL;</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Raportet e veprimtarisë së Departamentit të Administratës (DA) përmbajnë jo vetëm një analizë të detajuar të progresit dhe arritjeve, por ofrojnë gjithashtu rekomandime specifike për përmirësime të domosdoshme. Staf i është angazhuar në mënyrë aktive për zbatimin e këtyre rekomandimeve, të cilat burojnë nga proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Ky angazhim ndihmon në adresimin e dobësive dhe në forcimin e proceseve ekzistuese. Një analizë periodike mundëson një vlerësim të vazhdueshëm të efektivitetit të masave të ndërmarra, duke identifikuar mundësitë për optimizimin e qasjes dhe rritjen e efikasitetit të tyre. Për më tepër, integrimi i raporteve në nivel njësie kryesore dhe institucionit të arsimit të lartë (IAL) krijon një bazë për analiza krahasuese, që shërben për të vlerësuar situatën aktuale në raport me standardet dhe pritshmëritë. Ndërsa këto raporte dhe rekomandime përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit, një sfidë e vazhdueshme qëndron në sigurimin që masat e propozuara të realizohen në mënyrë sistematike dhe të monitorohen në mënyrë efektive. Për më tepër, analizat krahasuese nuk duhet të kufizohen vetëm në evidentimin e mangësive, por duhet të shërbejnë si një mjet për të nxitur inovacionin dhe praktikën më të mira brenda strukturave të IAL-ve. <i>Reference;</i>

	<i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Raportet e veprimtarisë së Departamentit të Administratës (DA) përmbajnë jo vetëm një analizë të detajuar të progresit dhe arritjeve, por ofrojnë gjithashtu rekomandime specifike për përmirësime të domosdoshme. Stafit është angazhuar në mënyrë aktive për zbatimin e këtyre rekomandimeve, të cilat burojnë nga proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Ky angazhim ndihmon në adresimin e dobësive dhe në forcimin e proceseve ekzistuese. Një analizë periodike mundëson një vlerësim të vazhdueshëm të efektivitetit të masave të ndërmarra, duke identifikuar mundësitë për optimizimin e qasjes dhe rritjen e efikasitetit të tyre. Për më tepër, integrimi i raporteve në nivel njësie kryesore dhe institucionit të arsimit të lartë (IAL) krijon një bazë për analiza krahasuese, që shërben për të vlerësuar situatën aktuale në raport me standardet dhe pritshmëritë. <i>Reference;</i> <i>Vizita dhe intervista ne IAL;</i>			
Konkluzione	<i>Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë në institucionet e arsimit të lartë mbështetet në dokumente të aksesueshme publikisht dhe instrumente matëse për mësimdhënie. Dobësitë adresohen përmes planeve dhe rekomandimeve specifike, duke promovuar përmirësimin e vazhdueshëm. Analiza periodike dhe integrimi i raporteve sigurojnë një bazë për përmirësim efektiv dhe krahasime ndërinstitutionale. Sfida mbetet implementimi i masave dhe ruajtja e një balance mes transparencës dhe privatësisë. Angazhimi i stafit dhe bashkëpunimi ndërdepartamental janë kyç për suksesin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Konkluzione	<i>Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë në institucionet e arsimit të lartë mbështetet në dokumente të aksesueshme publikisht dhe instrumente matëse për mësimdhënie. Dobësitë adresohen përmes planeve dhe rekomandimeve specifike, duke promovuar përmirësimin e vazhdueshëm. Analiza periodike dhe integrimi i raporteve sigurojnë një bazë për përmirësim efektiv dhe krahasime ndërinstitutionale. Sfida mbetet implementimi i masave dhe ruajtja e një balance mes transparencës dhe privatësisë. Angazhimi i stafit dhe bashkëpunimi ndërdepartamental janë kyç për suksesin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë (Master Profesional) në
"Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm"**

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Program studimi i mbështetur në një marrëveshje me Universitetin e Plovdiv Bullgari, me përvojë në fushën përkatëse të studimit.
2. Marrëveshje me institucione ndërkombëtare dhe fuqizim i stafit akademik dhe programit përmes projekteve të përbashkëta me ta.
3. Staf me përvojë dhe ndërveprim i mirë midis dy fakulteteve që përfaqësojnë fushat përkatëse të ndërlidhura në program, bujqësinë dhe turizmin, në sektorin e agroturizmit.
4. Infrastrukturë dhe teknologji moderne: Fakulteti i Bujqësisë dhe kampusi i UNIKO-s ofrojnë hapësira të ndërtuara sipas standardeve bashkëkohore, me auditore, laboratorë, dhe qendër kërkimore EDE të pajisura me teknologji të avancuar.
5. Sisteme dixhitale efektive: Implementimi i platformës "PITAGORA" dhe aksesimi i platformave online si Office 365 dhe JSTOR kanë rritur efikasitetin në administrim dhe ofrimin e burimeve akademike.
6. Përfshirja e studentëve: Politikat dhe procedurat sigurojnë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, vlerësimin e cilësisë dhe organizimin e aktiviteteve akademike.

Pikat e dobëta:

1. Mbivendosja e disa koncepteve të destinacionit në lëndët përkatëse dhe një shpërndarje jo e ekuilibruar mirë e lëndëve që con në mungesë të disa njohurive dhe aftësive të kërkuara sot në treg. (Standardi II4 Kriteri 2)
2. Mungesa e aftësive specifike që lidhen me digjitalizimin dhe TIK në programin e studimit, në formën e ndonjë lënde, apo temave brenda lëndëve të cilat i kanë të nevojshme këto njohuri dhe aftësi. (Standardi II4 Kriteri 2)
3. Mungesa e infrastrukturës specifike për praktika profesionale: Nuk disponohen makete për njësi shërbimi si akomodimi apo restorante, të cilat janë të rëndësishme për programet praktike në agroturizëm. Mbeshtetje jo në nivelin e duhur me këshillim ndaj studentëve, dhe për rrjedhojë, nuk mbahen evidenca në këtë drejtim. (Standardi V6 kriteri 3)
4. Implementimi i procedurave: Edhe pse ekzistojnë procedura të qarta, implementimi efektiv i tyre mbetet një sfidë në disa aspekte si praktikat profesionale dhe harmonizimi me nevojat e tregut. (Standardi IV2 kriteri 5)

Rekomandime:

1. Rishikimi i kurrikulës dhe analiza e tregut të punës në mënyrë që të shtohen aftësi të nevojshme për tregun si aftësitë e TIK, njohuri më të fokusuara drejt mjedisit dhe proceseve inovative në agro-turizëm.
2. Investime në infrastrukturë praktike: Krijimi i maketeve për njësi shërbimi si ferma didaktike apo restorante do të ndihmonte në përmirësimin e përvojës praktike të studentëve.
3. Përmirësim i implementimit të procedurave: Forcimi i monitorimit dhe zbatimit të procedurave ekzistuese për praktikat profesionale dhe kërkimore.

4. Trajnimi i stafit te karrierës në mënyrë që të jenë në gjendje të ofrojnë këshillim karriere ndaj studentëve.

Evaluation Conclusions of the Second Cycle Study Program (Professional Master's) in "Sustainable Management in Agritourism"

Strengths and Affirmations:

1. Study program supported by an agreement with the University of Plovdiv, Bulgaria, with experience in the relevant field of study.
2. Agreement with international institutions and strengthening of academic staff and the program through joint projects with them.
3. Experienced staff and good interaction between the two faculties representing the relevant fields related to the program, agriculture and tourism, in the agritourism sector.
4. Modern infrastructure and technology: The Faculty of Agriculture and the UNIKO campus offer spaces built to contemporary standards, including lecture halls, laboratories, and the EDE research center equipped with advanced technology.
5. Effective digital systems: The implementation of the "PITAGORA" platform and access to online platforms like Office 365 and JSTOR have enhanced administrative efficiency and the availability of academic resources.
6. Student involvement: Policies and procedures ensure active student participation in decision-making, quality assessments, and the organization of academic activities.

Weaknesses:

1. The overlap of some destination concepts in the relevant subjects and an unbalanced distribution of subjects leading to a lack of some knowledge and skills required in the market today.
2. The lack of specific skills related to digitalization and ICT in the study program, in the form of any subject, or topics within subjects that represent these knowledge and skills.
3. Lack of specific infrastructure for professional practices: There are no mock facilities for service units such as accommodation or restaurants, which are essential for practical programs in agritourism.
4. Implementation of procedures: While clear procedures exist, their effective execution remains a challenge, particularly in professional practices and alignment with market needs.

Recommendations:



1. Curriculum review and better labor market analysis in order to add skills needed for the market such as ICT skills, more environmentally focused knowledge, and innovative processes in agro-tourism.
2. Invest in practical infrastructure: Develop mock facilities for service units such as didactic farms or restaurants to enhance students' practical experience.
3. Improve procedural implementation: Strengthen the monitoring and enforcement of existing procedures for professional practices and research activities.
4. Train career counseling staff: Equip career counseling personnel with the skills needed to effectively support students in their professional development.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X


